



# MANUAL MBI QYTETARINË AKTIVE NJË GUIDË MBI AKTIVIZMIN RINOR



2018

Nga seritë e Edukimit Politik për të rinjtë/KRK/HSS  
Udhëzues/Doracak/1/2018

Autorë  
Dafina Peci  
Ili Gërdupi

Kontriboi dhe Editoi  
Shila Parllaku

© 2018 nga Kongresi Rinor Kombëtar



### **Kongresi Rinor Kombëtar**

Address: Rr. Milto Tutulani, Nd. 6, Hyrja 8/ 3 & 4, 1019,  
Tiranë – Shqipëri



Botimi i këtij manuali  
është mbështetur nga  
**Fondacioni Hanns-Seidel**

Gjetjet, opinionet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Hanns - Seidel.

<b>HYRJE</b>	5
<b>METODOLOGJIA</b>	5

### **MBI VLERAT, PARIMET DHE AKTIVITETET BAZE TE AKTIVIZMIT**

1.1	Të drejtat e njeriut	6
1.2	Vullnetarizmi	7
1.3	Edukimi jo-formal	8
1.4	Edukimi bashkëmoshatar	9
1.5	Loja e ekipit	10
1.6	Ndarja e roleve	13
1.7	Nxitje e mbështetjes në komunitet	14
1.8	Advokimi dhe lobimi	15
1.9	Deklaratë për mediat, fushatë PR, kurim imazhi	16

### **INFORMACIONE ME BAZE LIGJORE DHE DOKUMENTAT TIP PËR SECILIN RAST**

2.1	Parathënie	18
2.2	Protesta	19
2.3	Peticioni	22
2.4	Kërkesë për informacion	23
2.5	Kërkesë për dhënie vendimi kundër diskriminimit	25
2.6	Avokati i Popullit	29
2.7	Kontrata e vullnetarit	29
2.8	Regjistrimi në gjykat i Organizatave Jo-Fitimprurëse	30
2.9	Statuti i Shoqates (Dokument 7)	32
2.10	Akti i themelimit (Dokument 8)	35
2.11	Padia administrative nga një shoqatë ose grup interesi	36
2.12	Regjistrimi në tatime	37
2.13	Nisma ligjore qytetare dhe Referendumet	37

### **PROFLET E ORGANIZATAVE**

3.1	Shoqata New Bridges Berat	39
3.2	Grupimi "5 Plus"	41
3.3	Shoqata "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare"	44
3.4	Shoqata "Njerëzit të Parët"	46
3.5	Grupi ATA	48
3.6	Klubi Social Korçë	50
3.7	Këshilli Rajonal Rinor Kukës	51
3.8	Grupi rinor: Plantastik	51
3.9	Organizata Qendra Rinore Puke	53
3.10	Qendra ACT for SOCIETY	56
3.11	TPA Center	58

### **IMPAKTI, QËNDRUESHMËRIA ORGANIZATIVE DHE FINANCIAR**

4.1	Organizatave rinore	60
4.2	Udhëheqja e rinisë	61
4.3	Crowdfunding	62
4.4	Marrja e Veprimit	64
4.5	Emërtimet e institucioneve dhe linqet përkatëse	75

<b>BIBLIOGRAFIA</b>	76
---------------------	----

## HYRJA

Rinia shpesh e artikuluar si targeti më me rëndësi në politikat zhvillimore është edhe pjesa më vitale e shoqërise, e cila kërkon vëmendje dhe investim në të tashmen në mënyrë që e ardhmja të jetë e sigurtë dhe më e përparuar se koha që lihet pas. Nga puna jonë disa vjeçare si Kongres Rinor Kombëtar me rininë aktive në gjithë territorin e Shqipërisë kemi kuptuar se nevojat e tyre për informim, ngritje kapaciteti, orientim dhe motivim janë të vazhdueshme dhe kërkesa nga vetë të rinjtë për këto është në rritje. Përshtatja e dijes në lidhje me profilin e tyre dhe kontekstin mbetet ende sfidë e agjentëve, institucioneve dhe organizatave që punojnë me këtë target grup. Ky manual mbi aktivizmin rinor vjen si një përgjigje praktike dhe e shumëkërkuar për pasjen e një udhëzuesi të mirëfilltë ta aktivizmit rinor, mbi temat bazë, në gjuhën shqipe. Manuali përmban katër module kryesore, ku i pari përmban vlerat dhe temat bazë të aktivimit; i dyti informacionet ligjore për ndikim në vendimarrje dhe dokumentet tip; i treti mbi profilet e shëmbujve të suksesit dhe i fundit mbi qëndrueshmërinë organizative dhe financiare. Punimi është bazuar edhe në doracakë të ngjashëm të cilët njihen dhe përdoren ndërkombëtarisht lidhur me aktivizmin rinor dhe fuqizimin e të rinjve si: Amnesty International, Advocate for Youth, Compass, Youth Peer Education Toolkit etj. Ky manual do shpërndahet në formën elektronike dhe të printuar duke synuar organizatat rinore, organziatat e tjera që kanë në fokus rininë, grupet joformale, forumet rinore, qeveritë e nxënësve, aktivistët, studentët etj, çdo aktor që synon ushtrimin e të drejtave, forcimin e demokracisë, fuqizimin e të rinjve dhe ndikimin në ciklin e politikëbërjes.

## METODOLOGJIA

Ky punim është mbështetur në informacione të përftuara nga eksperiencia shumëvjeçare e autorëve në fushën e aktivizmit si dhe studime të ndryshme. Për sktrukturimin e informacioneve në këtë punim është përdorur metoda krahasuese, duke studiuar punime të ngjashme. Qasja e ndjekur vë së bashku formatin krahasimor duke e përshtatur atë me nevojat e aktivizmit rinor në Shqipëri, të dala në pah nga puna disa vjeçare me rrjetin e Kongresit Rinor Kombëtar. Krahas mbështetjes në modelet ekzistuese ky doracak/manual përmban një përshkrim të detajuar të koncepteve duke u përpjekur të jetë si informues edhe analitik. Kuadri teorik përfshin nevojat kryesore të domosdoshme për të nxitur aktivizmin, për faktin se është referuar edhe në studimet/manualet/broschurat ekzistuese të prodhuara nga organizata të njohura ndërkombëtare.

## KAPITULLI I

## MBI VLERAT, PARIMET DHE ELEMENTET BAZË TË AKTIVIZMIT

## TË DREJTAT E NJERIUT

Të drejtat e njeriut janë parime ose norma morale që përshkruajnë standarde të caktuara të sjelljes njerëzore dhe mbrohen rregullisht si të drejta ligjore në të drejtën komunale dhe ndërkombëtare. Ato zakonisht kuptohen si të drejta të patjetërsueshme për të cilat një person ka të drejtën e natyrshme për shkak se ai ose ajo është qenie njerëzore, pa u ndalur në vendndodhjen, gjuhën, fenë, origjinën etnike ose ndonjë status tjetër. Ato janë të zbatueshme kudo dhe në çdo kohë në kuptimin e qenies universale dhe janë unitare në kuptimin e të qenit të njëjta për të gjithë. Ato konsiderohen se kërkojnë ndjeshmëri dhe sundim të ligjit dhe vendosin një detyrim ndaj personave për të respektuar të drejtat e njeriut të të tjerëve dhe përgjithësisht konsiderohet se ato nuk duhet të shkelen, përveçse si rezultat i një procesi të rregullt të bazuar në rrethana specifike; për shembull, të drejtat e njeriut mund të përfshijnë lirinë nga burgimi i paligjshëm, tortura dhe ekzekutimi.

Doktrinat e të drejtave të njeriut kanë qenë shumë nën ndikimin e ligjit ndërkombëtar, institucioneve globale dhe rajonale. Në Shqipëri këto të drejta mbrohen në Kushtetutë dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Ndër institucionet që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri mund të përmendim Avokatin e Popullit, Komisionerin për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale, gjykatat, Gjykatën Kushtetuese, si dhe çdo institucion i administratës i cili do gjendej përballë një shkelje të këtyre të drejtave.

Mënyra më konkrete se si mund të ushtroni këto të drejta mund t'i gjeni në kapitullin 2 të këtij Manuali ku tregohen mjetet dhe institucionet që mund të përdoren në varësi të rastit. Ajo çfarë është e rëndësishme të kuptohet në lidhje me të drejtat e njeriut nga pikëpamja e aktiviteteve është vlera që ato kanë përkundrejt institucioneve qeverisëse. Gjatë punës tuaj mund të hasni shpesh herë në abuzime të ndryshme të të drejtave të njeriut dhe për këtë arsye është e rëndësishme që ju dhe anëtarët e grupit tuaj të jeni të informuar dhe në gjendje të identifikoni raste të shkeljeve, ku më pas mund të merrni masa.

**Udhëzime:**

- Informohuni se cilat janë të drejtat tuaja themelore. Ato mund t'i gjeni në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në mjaft dokumente të tjera të cilat mund të trajtojnë një fushë për të cilën ju mund të keni më shumë interes.
- Konsultohuni me persona që merren posaçërisht me mbrojtjen e të drejtave të njeriut sa herë dyshoni për shkelje të të drejtave, siç mund të jenë punonjës të organizatave ndërkombëtare, komisionerë të Avokatit të Popullit, avokatë dhe këdo tjetër i cili mund t'jua konfirmojë dyshimin që ju keni.
- Mundohuni të merrni pjesë vazhdimisht në trajnime që organizohen për informimin mbi të drejtat e njeriut, si dhe të nxisni pjesëmarrjen në këto trajnime të anëtarëve të tjerë të grupit tuaj.

**VULLNETARIZMI**

Vullnetarizmi në përgjithësi konsiderohet një veprimtari altruiste ku një individ ose grup ofron shërbime për asnjë përfitim financiar ose social "për të përfituar një person, grup ose organizatë tjetër". Vullnetarizmi është gjithashtu i njohur për zhvillimin e aftësive dhe shpesh synon të promovojë mirësinë ose të përmirësojë cilësinë e jetës së njerëzve. Vullnetarizmi mund të ketë përfitime pozitive për vullnetarin si dhe për personin ose komunitetin që shërben. Gjithashtu, synon të krijojë kontakte për punësim të mundshëm. Shumë vullnetarë janë trajnuar posaçërisht në zonat ku ata punojnë, siç janë mjekësia, arsimit ose ndihma e shpejtë.

Si pjesë e aktiviteteve që mund të organizohen, puna vullnetare është gjithmonë nga më të mirëpriturat për shkak se kërkon vetëm persona të gatshëm për të kontribuar nga koha e tyre dhe një problem për të cilin duhet punuar. Në Shqipëri puna vullnetare është rregulluar me ligjin Nr. 45 i vitit 2016 i cili përcakton kriteret dhe kushtet se si duhet zhvilluar puna vullnetare. Më shumë detaje për pjesën ligjore do trajtohen në Modulin tjetër ku do flitet për kontratën e vullnetarit.

Një formë gjithnjë e më popullore e vullnetarizmit në mesin e të rinjve, veçanërisht për studentët mund të jetë marrja e një viti pushim, dhe të udhëtojnë për komunitetet në vende të ndryshme të botës në zhvillim për të punuar në projekte me organizatat lokale. Aktivitetet përfshijnë mësimin e gjuhës angleze, punën në jetimore, ruajtjen, ndihmën ndaj organizatave joqeveritare dhe punën mjekësore. Vullnetarizmi ndërkombëtar shpesh synon t'u japë pjesëmarrësve shkathtësi dhe njohuri të vlefshme përveç përfitimeve për komunitetin pritës dhe organizatën. Një nga mundësitë e mira për vullnetarizëm jashtë Shqipërisë është programi i Komisionit Evropian i quajtur European Volunteer Service (EVS)<sup>1</sup>

është e rëndësishme që kur të filloni të planifikoni një aktivitet i cili do kërkonte angazhimin e vullnetarëve të kini të qartë se çfare detyrash do i kërkojnë vullnetarit të bëjë, dhe a janë këto detyra të përshtatshme. Nuk mund t'i kërkohej një vullnetari të kryej një punë për të cilën normalisht duhet të jetë një person i paguar i cili e kryen.

<sup>1</sup> [https://europa.eu/youth/volunteering/evs-organisation\\_en](https://europa.eu/youth/volunteering/evs-organisation_en)

**Udhëzime:**

- Mundohuni të përdorni sa më shumë nga koha juaj e lirë për të kryer punë vullnetare.
- Asnjëherë mos mbingarkoni me punë vullnetarët të cilët ju ndihmojnë për një aktivitet, pasi mund t'i hiqni atij dëshirën për t'u marrë me punë vullnetare në të ardhmen.
- Puna vullnetare nuk shpërblehet nga ana materiale, por shpërblehet me mirënjohje, sigurohuni të falenderoni gjithmonë vullnetarët pasi ka përfunduar puna.
- Vullnetarizmi jashtë vendit mund të jetë një mundësi e shkëlqyer për të eksploruar shtete të tjera, dhe për një eksperiencë jetë-ndryshuese. Konsiderojeni!

**EDUKIMI JO-FORMAL**

Edukimi jo-formal është çdo aktivitet edukativ i organizuar që zhvillohet jashtë sistemit arsimor shkollor. Zakonisht edukimi jo-formal është fleksibël, me në qendër nxënësin, dhe përdor një qasje që nxit pjesëmarrjen. Nuk ekziston një target-grup specifik; mund të jenë fëmijë, të rinj apo të rritur. Ka ende debat për përkufizimin e saktë se çfarë aktivitetesh ajo përfshin dhe çfarë përjashton.

Nëse pyesni veten se si mësonin njerëzit para se të shfaqej sistemi shkollor formal, do të mendonit për një formë të edukimit informal që ishte programi i shkrim-leximit në një fshat, burrat e moshuar të mençur që ua kalonin njohuritë e tyre brezave të rinj ose një fermeri që mëson ndihmësit e tij se si të rrisin bimët.

Termi edukim jo-formal është kryesisht i lidhur me fushën e zhvillimit dhe përdoret gjerësisht në diskutimet akademike për arsimin, veçanërisht nga organizatat ndërkombëtare të zhvillimit, si UNESCO, Këshilli i Evropës dhe organizatat joqeveritare lokale (OJQ). Kur u shfaq ky term, kryesisht ai u përqendrua në vendet në zhvillim, megjithëse shumica e diskutimeve u zhvilluan në Amerikën e Veriut dhe në një masë më të vogël në Evropën Perëndimore. Këto diskutime vazhduan gjatë viteve '70 dhe '80, për t'u rikthyer sërish në vitet '90. Këtë herë me një kuptim më të mirë të asaj që mund të arrijë dhe çfarë nuk mundet, megjithëse pa asnjë marrëveshje mbi përkufizimin.

**Pavarësisht nga përkufizimet e ndryshme, programet e edukimit jo-formal kanë një numër kriteresh për të cilat ka dakordësi:**

- Nxënësi luan një rol aktiv në mësimin e tyre dhe programi përshtatet me rrethanat e tyre;
- Kurrikula fleksibile që mund të ndryshohet. Shkalla e fleksibilitetit do të ndryshonte nga një program në tjetrin;
- Marrëdhëniet njerëzore janë më informale nga të mësuarit reciprok;
- Përqendrimi në aftësitë dhe njohuritë praktike;
- Grupet e pafavorizuara të synuara si të rinjtë, gratë, grupet e varfra dhe të marginalizuara

- Përdorimi kreativ i burimeve arsimore;
- Pjesëmarrja e komunitetit;
- Organizimi dhe menaxhimi i decentralizuar dhe më fleksibël.

#### **Udhëzime:**

- Mundohuni të merrni pjesë vazhdimisht në trajnime që organizohen duke u mbështetur në edukimin jo-formal.
- Përpiquni të lexoni metoda të edukimit jo-formal dhe mund t'i praktikoni ato tek anëtarët e tjerë të grupit tuaj.
- Jini të hapur ndaj metodave të reja të edukimit të cilat mund të duken të ndryshme nga ato çfarë ju jeni mësuar, por kanë efekte që i tejkalojnë xpritshmëritë.

## **ÇFARË ËSHTË EDUKIMI BASHKËMOSHATAR?**

(Peer to peer Education)

Edukimi i bashkëmoshatarëve është proces ku të rinjtë e trajnuar dhe të motivuar ndërmarrin aktivitete në kuadër të edukimit jo-formal ose të organizuara me kolegët e tyre (të ngjashme me veten në moshë, kapacitete ose interesa). Këto aktivitete, që ndodhin gjatë një periudhe relativisht të gjatë kohore, kanë për qëllim zhvillimin e njohurive, qëndrimeve, besimeve dhe aftësive të të rinjve duke u mundësuar atyre që të jenë përgjegjës dhe të ndërgjegjshëm për mbrojtjen e shëndetit të tyre. Edukimi i bashkëmoshatarëve mund të zhvillohet në grupe të vogla ose nëpërmjet kontaktit individual dhe në një mjedis të ndryshëm; shkollat, universitetet, klubet, kishat, vendet e punës, vende publike, strehëzat ose kudo që mblidhen të rinjtë. Shembuj të aktiviteteve të edukimit të të rinjve përfshijnë:

- Sesione të organizuara me nxënësit në një shkollë të mesme, ku mësuesit e bashkëmoshatarëve mund të përdorin teknika interaktive si përshembull, kuize, shfaqje të lojërave, luajtjen e roleve ose tregimet.
- Një shfaqje teatri në një klub rinor, pasuar nga diskutimet në grupe.
- Biseda joformale me të rinjtë në një bar/klub ku mund të flasim për mënyra të ndryshme. sjelljesh që mund të rrezikojnë shëndetin e tyre dhe ku mund të gjejnë më shumë informacion dhe ndihmë praktike.

Edukimi bashkëmoshatar mund të përdoret si metodë me grupmosha të ndryshme për qëllime të ndryshme. Kohët e fundit, edukimi bashkëmoshatar është përdorur gjerësisht në parandalimin e HIV / AIDS dhe programeve të shëndetit riprodhues në mbarë botën. Një bashkëmoshatar është një person i cili i përket të njëjtit grup shoqëror si një person apo grup tjetër. Përcaktimi i grupit shoqëror mund të bazohet në moshën, gjininë, orientimin seksual, gjendjen socio-ekonomike ose shëndetësore si dhe në faktorë të tjerë. Arsimi i referohet zhvillimit të njohurive, qëndrimeve, besimeve ose sjelljes së një personi si rezultat i procesit mësimor.



## Nga Teoria në Praktikë

Pse edukimi i bashkëmoshatarëve? Grupi i bashkëmoshatarëve të një të riu ka një ndikim të fortë në mënyrën se si ai ose ajo sillet. Kjo është e vërtetë si për sjelljet e rrezikshme ashtu edhe për ato më të sigurta. Nuk është e habitshme që të rinjtë të marrin një informacion të gjerë nga bashkëmoshatarët e tyre për çështje që janë tabu, veçanërisht të ndjeshme ose kulturore. Edukimi i ndërsjelltë brenda një grupi të caktuar me karakterin moshor të përbashkët ka rezultuar me ndikime pozitive në arritjen e një rezultatit. Besueshmëria e edukatorëve të bashkëmoshatarë brenda grupit cilësohet si një bazë e rëndësishme mbi të cilën mund të ndërtohet edukimi i suksesshëm i palës tjetër. Të rinjtë që kanë marrë pjesë në iniciativat e edukimit të bashkëmoshatarëve shpesh e lavdërojnë faktin se informacioni transmetohet më lehtë për shkak të sfondit dhe interesave të përbashkëta të edukatorit dhe audiencës në fusha të tilla si muzika dhe të famshmit, përdorimi i gjuhës, temat familjare dhe presioni, ngarkesa dhe aktualiteti i roleve sociale që këta individë mbartin. Proçesi i edukimit të bashkëmoshatarëve perceptohet si marrja e një këshille nga një mik i njohur, i cili ka shqetësime të ngjashme dhe një kuptim të asaj se si të jetë një i ri. Edukimi i bashkëmoshatarëve është gjithashtu një mënyrë për të fuqizuar të rinjtë; ai u ofron atyre mundësinë për të marrë pjesë në aktivitetet që i prekin ata dhe për të marrë informacionin dhe shërbimet e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e tyre.

Nëse jeni duke zbatuar një seminar trajnimi (TOT), trajnime të edukatorëve të bashkëmoshatarëve ose sesione të edukimit të ndërsjellë me popullatën e synuar, ekzistojnë disa konsiderata themelore metodologjike për përkthimin e teorisë në praktikë. Më e rëndësishmja është të mësuarit eksperimental (të mësuarit bazuar në përvojën dhe vëzhgimin) dhe përdorimin e metodologjive interaktive, përfshirë dramën. Mësimi i përvojës Më tregoni ... harrojmë, më tregoni ... Më kujtohet, më përfshini ... e kuptoj. Proverb i lashtë 'Përfshirja' e pjesëmarrësve në një seminar trajnimi në një mënyrë aktive që përfshin përvojën e tyre është thelbësore. Mësimi i tillë eksperiencial u jep të trajnuarve një mundësi për të filluar zhvillimin e aftësive të tyre dhe për të marrë reagime të menjëhershme. Gjithashtu u jep atyre mundësinë për të marrë pjesë në shumë nga stërvitjet dhe teknikat e para, para se të angazhohen në trajnime të tjera të trajnuar për edukatorë të bashkëmoshatarëve. Qasja TOT e propozuar në këtë manual bazohet në një model të përvojës së të nxënit me teknika shumë interaktive. Modeli përfshin katër elemente:

1. Pjesëmarrja;
2. Reflektimi mbi përvojën;
3. Përgjithësimi (mësimet e nxjerra)
4. Zbatimi i mësimëve të nxjerra.

## LOJA E EKIPIIT

Brainstorming (Rrahja e ideve)

Brainstorming është një mënyrë për të futur një subjekt të ri, për të nxitur krijimtarinë dhe për të gjeneruar shumë ide shumë shpejt. Mund të përdoret për zgjidhjen e një problemi specifik ose për t'iu përgjigjur një pyetjeje.

### Udhëzime:

- Vendosni për çështjen që dëshironi të mendoni dhe formuloni atë në një pyetje që ka shumë përgjigje të mundshme. Shkruani pyetjen ku mund ta shohin të gjithë.
- Kërkojuni njerëzve të kontribuojnë me idetë e tyre dhe të shkruajnë idetë ku secili mund ta shohë, për shembull në një tabelë. Këto duhet të jenë fjalë të vetme ose fraza të shkurtra.
- Ndaloni brainstorming kur idetë po mbarojnë dhe pastaj shikoni përmes sugjerimeve, duke kërkuar komente.

### Kini parasysh:

- Shkruani çdo propozim të ri. Shpesh, sugjerimet më krijuese janë më të dobishme dhe interesante!
- Askush nuk duhet të bëjë ndonjë koment apo të gjykojë atë që është shkruar para fundit të aktivitetit, ose të përsërisë idetë që tashmë janë thënë. Inkurajoni të gjithë që të kontribuojnë.
- Jepni idetë tuaja vetëm nëse është e nevojshme për të inkurajuar grupin.
- Nëse një sugjerim është i paqartë, kërkon sqarime.

### Shkrim i murit

Kjo është një tjetër formë e brainstorming. Pjesëmarrësit i shkruajnë idetë e tyre në copa të vogla letre (p.sh. "Post-it") dhe i ngjisin në një mur. Përparësitë e kësaj metode janë se njerëzit mund të ulen dhe të mendojnë në heshtje me veten e tyre para se të ndikohen nga idetë e të tjerëve dhe pjesët e letrës mund të ripozicionohen për të ndihmuar në grumbullimin e ideve.

Diskutimet janë një mënyrë e mirë për lehtësuesin dhe pjesëmarrësit të zbulojnë se cilat janë qëndrimet e tyre ndaj çështjeve. Kjo është shumë e rëndësishme në një trajnim sepse pjesëmarrësit gjithashtu duhet të shqyrtojnë dhe analizojnë çështjet për vete. Lajmet, posterat dhe studimet e rasteve janë mjete të dobishme për nxitjen e diskutimit. Filloni duke pyetur njerëzit "çfarë mendoni për ...?".

### Ndarja në grupe

Kjo është një metodë e dobishme nëse nuk ka ide në një diskutim në tërë grupin. Kërkojuni njerëzve të diskutojnë temën në çifte për një ose dy minuta dhe pastaj të ndajnë idetë e tyre me pjesën tjetër të grupit. Së shpejti do të gjeni atmosferën "gumëzhimë" me biseda dhe njerëz që "gumëzhijnë" me ide!

**Punë në grupe të vogla**

Puna e grupeve të vogla është në kontrast me punën e tërë grupit. Kjo është një metodë që i inkurajon të gjithë të marrin pjesë dhe ndihmon në zhvillimin e punës në ekip. Madhësia e një grupi të vogël do të varet nga gjërat praktike, si sa njerëz ka të gjithë së bashku dhe sa hapësirë keni. Një grup i vogël mund të jetë 2 ose 3 njerëz, por funksionon më mirë me 6-8. Puna e grupeve të vogla mund të zgjasë pesëmbëdhjetë minuta, një orë ose një ditë në varësi të detyrës së dhënë.

Është rrallë produktive t'u thuash njerëzve thjesht të "diskutojnë çështjen". Cilado qoftë tema, është thelbësore që puna të përcaktohet qartë dhe se njerëzit të jenë të përqendruar në punën drejt një qëllimi që kërkon nga ata të reagojnë në të gjithë grupin. Për shembull, caktoni një detyrë në formën e një problemi që duhet zgjidhur ose një pyetje që kërkon përgjigje.

**Renditja e shkallëve**

Kjo është një metodë e dobishme për t'u përdorur kur doni të jepni informacion specifik ose të stimuloni një diskutim të fokusuar në grupe të vogla.

Ju duhet të përgatitni një grup letrash me fjali për secilin grup të vogël. Duhet të ketë 9 copa letre për set. Përgatitni 9 fjali të shkurtra dhe të thjeshta në lidhje me temën që dëshironi që njerëzit të diskutojnë dhe të shkruajnë një fjali për secilën copë letre.

Grupet duhet të diskutojnë fjalitë dhe pastaj t'i rendisin ato sipas rëndësisë. Kjo ose mund të bëhet si një shkallë. Në renditjen e shkallëve, fjalia më e rëndësishme është vendosur në krye, më e rëndësishmja pasuese nën të dhe kështu me radhë në fjalinë më pak të rëndësishme në pjesën e poshtme.

**Udhëzime të përgjithshme për aktivitetet:****Bashkëtrajneri**

Nëse është e mundur, gjithnjë zhvillojeni trajnimin bashkë me dikë tjetër. Ekzistojnë përparësi praktike nëse do të ketë dy njerëz për të ndarë përgjegjësinë për të ndihmuar me punën e grupeve të vogla ose që kanë të bëjnë me nevojat individuale. Kur dy njerëz drejtojnë një seancë, është më e lehtë të ndryshohet ritmi për t'i mbajtur gjërat interesante. Dy trajnues mund të mbështesin njëri-tjetrin nëse gjërat nuk shkojnë ashtu siç është planifikuar dhe është gjithashtu më e dobishme për të bërë një rishikim me dikë tjetër sesa për ta bërë atë vetëm. Më e mira është të zhvillosh aktivitetet në një ekip, ndoshta duke përfshirë disa të rinj në përgatitje.

**Menaxhimi i kohës**

Planifikoni me kujdes dhe mos provoni të mbushni sa më shumë kohë. Nëse aktiviteti po zgjat më shumë nga sa e keni parashikuar, përpiquni ta shkurtoni atë në mënyrë që të keni mjaft kohë për diskutimet. Nga ana tjetër, nëse keni shumë kohë në dorë, mos u përpiqni të tërhiqni diskutimin, të keni një pushim ose të bëni një aktivitet të shpejtë energjie për argëtim.

**Krijoni një mjedis ftues**

Njerëzit duhet të ndjehen të lirë për të eksploruar dhe zbuluar, për të bashkëvepruar dhe për të ndarë me njëri-tjetrin. Jini të sinqertë, miqësor, inkurajues dhe me humor. Mos përdorni zhargon ose gjuhë që pjesëmarrësit nuk e kuptojnë.

### **Vendosni rregulla bazë**

Është e rëndësishme që të gjithë në grup të kuptojnë rregullat bazë për aktivitetet pjesëmarrëse dhe eksperimentale. Për shembull, të gjithë duhet të marrin pjesën e tyre të përgjegjësisë për seancën, që të gjithë të kenë mundësinë të dëgjohen, të flasin dhe të marrin pjesë. Askush nuk duhet të ndihet nën presion për të thënë diçka që nuk ndjehen rehat. Këto rregulla bazë mund të diskutohen dhe të pranohen kur të filloni të punoni me një klasë ose grup.

### **Jepni udhëzime të qarta**

Gjithmonë sigurohuni që të gjithë të kenë kuptuar udhëzimet dhe të dinë se çfarë duhet të bëjnë. Mënyra më e thjeshtë është të ftojni për të bërë pyetje dhe të shkruajnë atë që është më e rëndësishmja. Mos kini frikë nga pyetjet; ato janë shumë të dobishme dhe ju japin mundësinë për të sqaruar gjërat. Nëse nuk ka pyetje nganjëherë tregon një shenjë konfuzioni të përgjithshëm.

### **Ndarja e roleve**

Grupime të ndryshme, qofshin ato organizata të regjistruara apo grupe informale, kanë gjithmonë një strukturë organizimi. Struktura është gjithmonë e rëndësishme të jetë e qartë për të gjithë anëtarët e grupit në mënyrë që gjithësecili të dijë përgjegjësitë e tij, si dhe kujt duhet t'i kërkojë përmbushjen e një detyre të caktuar. Dy ndarjet kryesore në strukturën e organizimit janë: struktura hierarkike dhe struktura e sheshtë.

Struktura hierarkike ka nivele të ndryshme menaxhimi, ku anëtarët japin llogari te një epror që është më lartë, por kanë edhe anëtarë vartës. Në këtë strukturë anëtari më i thjeshtë ka vetëm drejtues, ndërsa ai që është në krye të hierarkisë ka vetëm vartës. Shembull i kësaj mund të shërbejë administrata publike qëndrore ku rolet janë të ndara në: Specialist, Shef Sektori, Drejtor i drejtorisë, Drejtor i Përgjithshëm, dhe Sekretar i Përgjithshëm.

Në ndryshim nga struktura hierarkike, struktura e sheshtë ka pak ose aspak nivele menaxhimi ku mund të ketë një drejtues të vetëm, ndërkohë që të gjithë anëtarët e tjerë të strukturës janë të barabartë me njëri tjetrin. Në të njëjtën kohë struktura e sheshtë mund edhe të mos ketë asnjë drejtues dhe gjithësecili nga anëtarët është përgjegjës i plotë për pjesën e tij të punës në organizatë. Avantazhet e një strukture hierarkike janë pasja e një përgjegjësie të qartë nëse puna nuk kryhet ashtu siç duhet, ndërsa një strukturë e sheshtë e ka përgjegjësinë kolektive për aq kohë sa nuk ka detyra të mirëpërcaktuara. Kreativiteti që të ofron pavarësia është pjesa ku çalon struktura hierarkike dhe avantazhohet struktura e sheshtë. Nëse aktivistët ndjejnë se nuk kanë dikë mbi kokë i cili do i hedhi poshtë idetë e tyre, ndihen më të incitivuar për të gjeneruar ide të reja.

Përveç ndarjes strukturore, ndarja e roleve në organizimin e takimeve ose aktiviteteve është mjaft e rëndësishme. Role të tilla si organizatori, moderatori, personi që mban shënimet, ose atij që mat kohën janë të rëndësishme për një takim sa më të efektshëm. Mënyra se si caktohet ndarja është në varësi të grupimit, ku një ndarje e tillë mund të jetë e përhershme ose me rotacion. E rëndësishme është që takimet të kenë gjithnjë një regjistrim i cili mundëson që idetë që diskutohen të mund të ruhen dhe të përpunohen për aktivitetet e ardhshme.

**Udhëzime:**

- Mundohuni të keni një strukturë ku është e thjeshtë mjaftueshëm për të kuptuar detyrat, por ama me aq shkallë sa menaxhimi i saj të jetë i mundur.
- Shmangni inflacionin e titujve në strukturën e organizatës.
- Mos krijoni pozicione të cilat nuk kanë asnjë person në menaxhim apo detyrë konkrete.
- Mundohuni që përbërja e strukturës të jetë sa më gjithëpërfshirëse. Pasja e një numri të barabartë të djemve dhe vajzave do t'ju ndihmojë të mos limitoheni te vetëm një kategori dhe t'i ofroni mundësi sa më shumë njerëzve.
- Pavarësisht mënyrës që zgjidhni për të vendosur persona në strukturë, qoftë me zgjedhje, apo me emërim, mundohuni të tregoheni sa më meri tokratik. Nëse anëtarë të grupit tuaj do ndihen se nuk po bëhen vlerësime meritokratike ata mund të demoralizohen dhe të ulin produktivitetin.

**NXITJE E MBËSHTETJES NË KOMUNITET**

Kur një organizatë ose grup informal punon me një komunitet të caktuar, është e rëndësishme që ajo të ketë mbështetjen e atij komuniteti. Kjo mbështetje do e bënte punën më të lehtë për ju, si dhe do ju nxiste me ide të reja se si mund t'i shërbenit më mirë atij komuniteti. Zakonisht, 5 deri në 10 për qind e anëtarëve të komunitetit do të mbështesin projektin fillimisht dhe 5 deri në 10 për qind e njerëzve do ta kundërshtojnë atë. Kundërshtarët ose mbështetësit nuk kanë gjasa të ndryshojnë pozicionin e tyre. Pjesa e mbetur prej 80 për qind, e quajtur shumica e heshtur, janë ose të pavendosur, indiferentë ose skeptikë rreth projektit.

Dështimi për të sjellë shumicën e heshtur në anën tuaj mund të rrezikojë seriozisht projektin. Strategjitë e ndryshme të komunikimit mund të përdoren për të fituar mbështetjen e këtij grupi.

Nëse ka persona të rinj nga komuniteti që interesohen për punën tuaj, bëjini ata të ndjehen të mirëpritur. Mos harroni të prezantoheni dhe shkurtimisht të shpjegoni qëllimin e grupit tuaj, si dhe mund të organizoni biseda, tregoni DVD, mbani diskutime, organizoni veprime krijuese. Mundohuni të mos i zgjasni takimet pafund dhe kërkonit reague në fund të mbledhjes.

Tregojini njerëzve se mund të bëjnë një ndryshim dhe jini të hapur ndaj ideve dhe sugjerimeve të reja. Tregoni mirënjohje për përpjekjet e njerëzve të komunitetit për t'ju ndihmuar.

**Udhëzime:**

- Jepuni kohë anëtarëve të komunitetit të mësohen me prezencën tuaj. Njeriu nga natyra është skeptik dhe kërkon kohë për t'u përshtatur me një situatë të re.
- Jini të hapur ndaj punës tuaj dhe mos krijoni përshtypjen se keni diçka për të fshehur.
- Mos premtoni objektiva të porealizueshëm, por qëndroni realist, pasi njerëzit mund të zhgënjehen lehtësisht nëse ju nuk i arrini ato që keni premtuar.

## ADVOKIMI DHE LOBIMI

Advokimi dhe lobimi janë kanale të fuqishme komunikimi direkt me objektivat e qeverisë. Qëllimet e avokimit dhe lobimit janë të ngjashme, por proceset janë të ndryshme. Avokimi përqipet të shkaktojë veprim politik duke përdorur metoda të tilla si edukimi qytetar dhe fushata publike që ndikojnë te vendim-marrësit, ndërsa lobimi i referohet ndikimit të qeverisë dhe udhëheqësve të saj.

Lobimi i drejtpërdrejtë është t'i komunikosh pikëpamjet tuaja një ligjvënësi ose një anëtar të stafit ose çdo punonjësi tjetër qeveritar, i cili mund të ndihmojë në zhvillimin e legjislacionit. Në mënyrë që ky komunikim të konsiderohet lobim i drejtpërdrejtë, ai duhet t'i referohet legjislacionit specifik dhe duhet të pasqyrojë një pikëpamje mbi legjislacionin e tillë.

Advokimi është të përqipesh të ndikosh publikun për të shprehur një pikëpamje specifike për ligjvënësit e tyre lidhur me një propozim legjislativ specifik. Për t'u marrë parasysh advokimi në nivel lokal, komunikimi duhet t'i referohet legjislacionit specifik, duhet të pasqyrojë një qasje mbi legjislacionin dhe duhet të inkurajojë marrësin e komunikimit për të ndërmarrë veprime në lidhje me ligjin. Avokimi është një grup i gjerë aktiviteteve që synojnë ndryshimin e opinionit publik ose marrjen e mbështetjes publike.

Duke advokuar në përfaqësuesit tuaj të zgjedhur në këshilla bashkiak ose deputet të Kuvendit, ju mund t'i ndihmoni t'i bindni ata të marrin masa kundër abuzimeve që ndodhin në komunitetin ku ju jetoni dhe ti jepni zgjidhje shqetësimeve të komunitetit. Advokimi si mjet funksionon në mënyrë të efektshme vetëm ndaj individëve që mbajnë poste publike për të cilat janë zgjedhur me votë, pasi funksionarët e tjerë publik zgjidhen përmes procedurave të konkurrimit dhe shpesh nuk kanë autoritet për të hartuar politika.

Gjëja e parë që duhet të bëni është të zbuloni se te cili përfaqësues duhet të jetë lobimi - kjo do të ndryshojë në varësi të çështjes. Çdo parlament ose këshill është përgjegjës për fusha të ndryshme ose punë, kështu që ju duhet të siguroheni që keni gjetur pikërisht personin e duhur për çështjen. Organe të ndryshme të qeverisjes kanë funksione të ndryshme dhe nëse kjo nuk do jetë shumë e qartë nga ana juaj, mund t'ju shkoj munda nëse do i kërkonti një përfitim për komunitetin e cila nuk është kompetencë e tij. Një shembull i kësaj është shtrimi i një rruge të prishur ku nëse rruga ndodhet brenda qytetit ju duhet të advokoni pranë Kryetarit të Bashkisë dhe/ose anëtarëve të Këshillit Bashkiak, ndërsa nëse ajo është një rrugë ndërqytetase, kompetenca për ta rregulluar atë i takon Autoritetit të Rrugëve dhe ju do mund të advokoni pranë deputetit të zonës i cili ka më shumë akses tek organet e administratës dhe gjithashtu mund të ndikojë në shpërndarjen e fondeve kur bëhet diskutimi i buxhetit.

Ju mund të zgjidhni t'i kërkonti këtyre përfaqësuesve t'ju takojnë ose mund t'i ftoni ata në një prej aktiviteteve që ju organizoni. Për shkak se përgjithësisht këta persona kanë orare mjaft të ngarkuara, rruga më e mirë është t'i dërgoni atyre një letër/email dhe nëse ata nuk ju kthejnë përgjigje brenda 10 ditëve mund t'i telefononi për t'i rikujtuar për kërkesën tuaj për takim, apo ftesën për të marrë pjesë në aktivitetin që ju organizoni.

**Udhëzime:**

- Përcaktoni qartë që në fillim kush është përfaqësuesi të cilit ju duhet t'i drejtoheni.
- Vendosni nëse do zgjidhni strategjinë e lobimit apo atë të advokimit.
- Në takim me përfaqësuesin vishuni seriozë dhe tregohuni korrekt me orarin.
- Kërkojini atij t'ju pajisi me çfarëdo dokumenti disponon i cili lidhet me çështjen për të cilën ju keni kërkuar ta takoni.
- Mos harroni t'i dërgoni një letër/email falenderimi për takimin, si dhe t'a informoni nëse shqetësimi për të cilin e takuat u zgjidh.
- Në takim është e këshillueshme të mos shkoni më shumë se tre përfaqësues nga grupi juaj.

**DEKLARATË PER MEDIAT, FUSHATE PR, KURIM IMAZHI****Si të shkruash njoftime për shtyp**

Një mënyrë e shkëlqyer për të përhapur mesazhin e të drejtave të njeriut është duke e pasqyruar atë në lajme. Njoftimet për shtyp munden të jenë rreth fillimit të një grupi të ri, ngjarjeje, ndërtimit të një objekti për komunitetin - në fakt, për çdo gjë që dëshironi!

Të qënurit student ka një përparësi të madhe kur ke të bësh me punën e shtypit, pasi mediat zakonisht priren për të mbuluar ngjarjet në lidhje me të rinjtë.

**Ja se si ta bëni këtë:**

**Hapi 1:** Nëse ju do të bëni një foto për ta dërguar për njoftim për shtyp, merrni leje nga të gjithë prindërit për personat nën 18 vjeç në fotografi.

**Hapi 2:** Shkruani njoftimin tuaj për shtyp.

**Hapi 3:** Gjeni se kujt duhet t'ja dërgoni.

**Hapi 4:** Dërgojeni me email ose postë. Sigurohuni që t'a dërgoni në kohën e duhur.

**Hapi 5:** Bëni një telefonatë pasuese.

**Elementët që duhet të përmbajë:**

- Data është jetike.
- Nëntitulli duhet të përfshijë mesazhin e dytë që ju doni të përçoni.
- Gjëja e parë që një redaktor lajmesh sheh është titulli dhe ai duhet të jetë tërheqës.
- Hyrja duhet të përfshijë çfarë, kur, ku, pse dhe kush.
- Emri i grupit ose shkollës.
- Përfshini një koment nga një prej pjesëmarrësve në ngjarjen për të cilën po dërgoni njoftimin.
- Mediat e duan një këndvështrim personal.

**Udhëzime:**

- Gjithmonë vendosni datën në deklaratën tuaj për shtyp. Nëse gazetari mund ta përdorë informacionin menjëherë, atëherë vendosni "Për botim të menjëhershëm" në krye të saj. Nëse nuk dëshironi që informacioni të publikohet para një date të caktuar atëherë vendosni "Të mos publikohet deri në ...".
- Sigurohuni që të filloni me një titull i cili është informativ dhe që mbetet në mendje. Shpesh kjo është pjesa e vetme e shtypit që një gazetar do të lexojë - ata do të përdorin titullin për të vendosur nëse do e lexojnë.
- Një njoftim ideal për shtyp është një faqe e gjysëm A4. Mos shkruani paragrafë shumë të gjatë ose fjali shumë të gjata.
- Përqëndrohuni te faktet!
- Gjithmonë theksoni rëndësinë për komunitetin- bëni të qartë për gaze tarët pse ngjarja juaj është diçka që banorët do të jenë të interesuar.
- Nëse ka një "mundësi fotografie", deklaroni këtë në fund të njoftimit për shtyp, me datat, kohën, numrat e kontaktit dhe një adresën e emailit. Mos harroni të merrni lejen e prindërve për çdo foto me persona nën 18 vjeç! Gjithmonë kontrolloni saktësinë dhe kontrolloni dy herë për gabimet gramatikore kur të keni mbaruar.
- Detajet e kontaktit janë esenciale pasi gazetarët duhet të kontaktojnë personin e duhur. Vendosni me antarët e grupit tuaj se kush duhet vënë si pikë kontakti.
- Përfshini një shpjegim të shkurtër të njoftimit tuaj.

**Ku ta dërgoni atë:**

Gjithmonë përpiquni të gjeni emrin e redaktorit që do të dërgoni njoftimin për shtyp, dhe adresën e tyre të postës elektronike ose postare. Një burim i mirë për të gjithë këtë informacioni është faqja e vetë gazetës ose televizionit

**Gazetë Lokale / Radio lokale / TV**

Dërgoje te Redaktuesi i Lajmit.

**Kur ta dërgoni atë:****Gazetë Lokale**

Për gazetatat të cilat nuk botohen çdo ditë duhet të dini se kur ato shkojnë për t'u shtypur dhe ta dërgoni atë përpara kësaj dite. Nëse dëshironi që një gazetar të vijë në veprimtarinë tuaj, duhet t'i njoftoni ata një javë përpara.

**Radio lokale / TV**

Dërgo njoftimin për shtyp në mënyrë që të arrijë dy ditë para ngjarjes.

**Thirrje telefonike pasuese**

Gjithmonë mbasi të dërgoni njoftimin tuaj për shtyp bëni një telefonatë të nesërmen gazetarit që e merr atë. Kur ta pyesni nëse ata do e mbulojnë ngjarjen, mos harroni të theksoni rëndësinë për komunitetin.



## KAPITULLII

INFORMACIONE ME BAZË LIGJORE DHE  
DOKUMENTAT TIP PËR SECILIN RAST

## PARATHËNIE

Ky kapitull synon t'i vijë në ndihmë të gjithë atyre të rinjve të cilët nuk kanë marrë aspak edukim ligjor formal, dhe dëshirojnë të kenë një informacion të përgjithshëm për ato pjesë të ligjit me të cilat ndeshen më shpesh organizatat. Informacionet që ju jepen në këtë kapitull janë informacione bazë për secilën fushë dhe nuk mund të zëvendësojnë ndihmën e ofruar nga një specialist ligjor. Përdorimi i efektshtëm i këtij informacioni do të ishte në formën e një orientimi të përgjithshëm për një fushë ku ju mund të keni njohuri të pakta.

Gjithmonë referojuni ligjit, të cilin e keni të cituar edhe në këtë material, për të gjitha rastet që kanë të bëjnë me çështje konkrete, dhe mos hezitoni të kontaktoni një avokat të licencuar, ose të konsultoheni me autoritetet publike. Të gjitha shembujt e shkresave të paraqitura në këtë Manual synojnë të krijojnë vetëm një ide të përafërt me formën që duhet të ketë shkresa, pa qënë shteruesepër formën dhe përmbajtjen e saj.

Në të gjitha rastet kur për arsye ilustrative duhej përdorur një emër aplikuesi, është zgjedhur John Doe si emri i përdorur për një person të paidentifikuar, ndërsa mbiemrat e zyrtarëve janë vendosur Hoxha, si mbiemri më i përhapur në Shqipëri. Kurse kur duhej përmendur një organizatë është vendosur emri "Rinia" për shkak se është një emër shumë i përgjithshëm që nuk i përket asnjë organizate të vetme. Ju mund t'i përdorni ato si një dokument tip ku i shtoni ose i hiqni ato pjesë që mendoni se do i përshtateshin më së miri situatës tuaj konkrete. Në rastet e informacioneve për institucione specifike ato janë marrë përmes kërkesave për informim, ose drejtpërdrejt nga faqet e tyre të internetit kur ai informacion ka qënë i lirë. Në dokumentat model, në ato raste ka vet institucioni ka vendosur një model të dokumentit është vendosur ai.

Autorit të këtij kapitulli i është dashur shpesh here të përballlet me situata kur pasja e këtyre njohurive ishte një domosdoshmëri, dhe uron të tregohen të vlefshme edhe për ju.



## PROTESTA

Protesta është një nga mjetet demokratike për të kundërshtuar një akt administrativ, një plan të propozuar, një politikë të ndjekur, ose një vendim që pritet të merret, kur ky veprim prek interesin publik, ose interesin e një komuniteti të konsiderueshëm. E drejta për të protestuar është e garantuar në nenin 47 të Kushtetutës<sup>2</sup> si dhe në nenin 11 të Konvetës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut<sup>3</sup> si dhe është e rregulluar me ligjin “Për tubimet”<sup>4</sup>

Në ligjin “Për tubimet” përcaktohen qartë kriteret të cilat duhet të ndiqen për të organizuar një tubim të ligjshëm, ku veprimi i parë është të njoftohet komisarjati i policisë së zonës që mbulon vendin ku do të organizohet tubimi me një kërkesë (shih modelin në Dokumenti 1). Njoftimi duhet të dorzohet të paktën 72 orë përpara organizimit të protestës, ndërsa lejohet që për raste urgjente që duhen argumentuar, mund të mos respektohet afati por të dorëzohet deri në 3 orë përpara protestës. Njoftimi duhet të përmbajë qëllimin e protestës, identitetin e organizatorëve, vendin ku do organizohet, kohëzgjatjen, personat që do flasin në tubim nëse do ketë, dhe numrin e përafërt të pjesëmarrësve.

Mbasi njoftimi është dorzuar, organizatori do njoftohet nga shefi i komisarjatis pranë të cilit ka depozituar kërkesën për dhënien ose jo të lejes, kufizime të mundëshme, dhe kontaktet e oficerit që do të caktohet për të siguruar mbarëvajtjen e protestës. Arsyet për të cilat shefi i komisarjatis mund të ndalojë organizimin e tubimit duhet të jenë vetëm në rast se rrezikohet siguria kombëtare, siguria publike, mbrojtja e rendit dhe parandalimi i një krimi, ruajtja e shëndetit ose moralit, ose mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të tjerëve. Vetëm në rastin e Bashkisë së Tiranës, njoftimi nuk do të dorëzohet në komisarjatin e zonës ku do të organizohet tubimi, por do të dorëzohet në Drejtorinë e Policisë së Qarkut të Tiranës, për shkak të fragmentarizimit të policisë së qytetit në disa komisarjate. Shefi i Komisarjatis në të cilin është depozituar kërkesa duhet të shprehet 24 orë mbas marrjes së njoftimit, ose brenda 8 orëve kur njoftimi i parë është dërguar mbrapsht për shkak se ka të meta.

### **Gjatë organizimit të protestës është e rëndësishme të mbahet parasysh:**

1. Ndalohet pjesëmarrja e personave të armatosur.
2. Ndalohet mbajtja e maskave, ose veshjeve të tjera të cilat fshehin identitetin.
3. Ndalohet zgjatja e protestës mbi afatet për të cilat është dhënë leja.
4. Ndalohet lëvizja e protestës jashtë vendit ose jashtë itinerarit për të cilin është marrë leja.

Ndalohet kryerja e veprimeve të dhunshme gjatë organizimit të një proteste.

<sup>2</sup>Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor

<sup>3</sup>Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr.8137 datë 31.7.1996

<sup>4</sup>“Për tubimet”, miratuar me ligjin Nr.8773, datë 23.4.2001

Nëse një nga kriteret e mësipërme nuk zbatohet, policia ka të drejtë të përjashtojë pjesmarrës nga protesta, ose edhe të urdhërojë shpërndarjen e protestës. Gjithashtu shkelja e këtyre ndalimeve mund të sjellë si pasojë fillimin e ndjekjes penale për organizatorët, dhe pjesëmarrësit në protestë nëse ata nuk shpërndahen mbas dhënies së urdhërit të policisë.



### Kërkesë për zhvillim tubimi (Dokument 1)

**Lënda:** Njoftimi i policisë së rendit për zhvillimin e tubimit në datën dd.mm.vvv në qendër të qytetit

**Drejtuar:** Komisariatit X

**Baza ligjore:** Ligji "Për tubimet", miratuar me ligjin Nr.8773, datë 23.4.2001

I nderuar Shefi Komisariatit X,

Me anë të kësaj letre dua t'ju vë në dijeni se në datën dd.mm.vvv do organizojmë një tubim paqësor në qendër të qytetit me qëllim për të kundërshtuar vendimin e fundit të kryetarit të bashkisë. Tubimi do fillojë në orën 12:00 dhe pritet të mbarojë në orën 14:00, dhe pritet të marrin pjesë 400 persona, ku nuk do mbahen fjalime.

Organizatorë të tubimit janë:

John Doe, lindur më dd.mm.vvv, banues në adresën Rr. X, Pll. 1, Ap. 2

Filan Fisteku, lindur më dd.mm.vvv, banues në Lagjen Nr. 3, banesë private me numër 4

Duke ju falenderuar për mirëkuptimi, presim përgjigjen tuaj brënda 24 orëve së bashku me kontaktet e oficerit të caktuar për mbarvajtjen e tubimit.

Me respekt,  
John Doe

### Ankesa

Kurdo që gjendeni përballë një akti administrativ ose një mosveprimi të organeve të administratës publike qëndrore ose vendore të cilin ju e konsideroni të paligjshëm, ju keni të drejtë të ankoheni. Afati për të bërë ankesën është i ndryshëm në varësi të aktit dhe të organit që e ka lëshuar atë, ku afati mund të variojë nga 5 ditë në 3 muaj. Akti që kundërshtohet me anë të ankimit duhet të ketë të përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit<sup>5</sup>. Një model të ankesës mund ta gjeni në model Dokumenti 2, ku shkurtimisht janë vendosur të dhënat që duhet të keni parasysh në momentin e hartimit të kërkesës.

<sup>5</sup> Kodi i Procedurave Administrative, miratuar me Ligjin Nr. 44/2015 në datën 30.4.2015

Veprimi i parë që duhet të bëni është të kontrolloni ligjin që rregullon institucionin ndaj të cilit ju po i drejtoni ankesën. Është e rëndësishme që kur t'i parashtroni arsyet e ankimit tuaj, ato të jenë të bazuara në ligjin që e rregullon organin, për ta bërë ankimin tuaj më të qartë, pasi edhe kur nuk keni bërë emërtimin e duhur, nëse është e qartë ndaj kujt akti po ankoheni ai do merret parasysh.

Ju mund t'ia dërgoni ankimin organit që e ka nxjerrë aktin, organit epror i organit që ka nxjerrë aktin (prsh. drejtorisë së përgjithshme, nëse akti është nxjerrë nga drejtoria rajonale), ose organit që është përcaktuar shprehimisht nga ligji. Nëse ia keni dërguar gabimisht organit epror, kjo nuk përbën problem pasi ai ka detyrimin që t'ia dërgojë atë organit kompetent.

### Ankes (Dokument 2)



**Lënda:** Ankim kundër aktit (emërtimi i aktit, datën e nxjerrë, dhe numri i i protokollit) të nxjerrë nga Institucioni/Bashkia/Ministria X

**Drejtuar:** Institucionit/Bashkisë/Ministrisë X (institucioni që ka nxjerr aktin)

**Baza ligjore:** Neni 128 i Kodit të Procedurave Administrative, miratuar me Ligjin Nr. 44/2015 në datën 30.4.2015

I nderuar Z. Hoxha,

Unë i nënshkruari John Doe, përfaqësues ligjor i organizatës "Rinia" jam vënë në dijeni se në datën dd.mm.vvvv institucioni juaj ka nxjerr një shkresë me numër protokollit 123/1, ku i keni refuzuar mbështetjen e kërkuar organizatës "Rinia". Me anë të kësaj letre dua t'ju bëj me dije se aryet e dhëna në shkresë për refuzimin e kërkesës nuk qëndrojnë (rendit pikat që nuk qëndrojnë). Organizata "Rinia" e meriton mbështetjen e kërkuar pasi i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura në udhëzimin 987 të institucioni tuaj.

Për sa më sipër, ne ju kërkojmë ta rimerrni në shqyrtim kërkesën tonë për mbështetje dhe ta vlerësoni atë si të bazuar në ligj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimi, presim përgjigjen tuaj ndaj kërkesës tonë, dhe shpresojmë në bashkëpunime të ardhshme.

Me respekt,  
John Doe

## PETICIONI

Peticioni është një nga format më të përhapura të angazhimit qytetar në Shqipëri, ku një organizatë ose një grup interesi mbledhin firmat e të gjithë qytetarëve që i mbështesin ata për një çështje të caktuar. Në Kodin e Procedurave Administrative të vitit 1999, tashmë i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurave Administrative në vitin 2015, peticioni përmendej në mënyrë konkrete si një formë ligjore të ngjashme me kërkesën, ku një grup qytetarësh mund t'i drejtoheshin organeve të administratës publike në lidhje me shqetësimet që ata kishin.

Më shumë sesa efekti ligjor, peticioni përdoret kryesisht si një mënyrë për të krijuar trysni publike ndaj funksionarëve të administratës se shqetësimi për të cilin ata janë ngritur prek një numër të madh qytetarësh, të cilët e kanë shprehur këtë nëpërmjet nënshkrimit të një kërkesë të përbashkët. Ndryshe nga formularët e të dhënave për dhënien e mbështetjes për referendumet, ose kandidatët e pavarur, nuk ka një formë të paracaktuar nga ligji që duhet të ketë peticioni, ose të dhënat që duhet të përmbajë. Pavarësisht kësaj, një model se çfarë elementësh dhe forme kanë patur peticionet e organizuara deri më tani, mund ta shihni në model Dokumenti 3.

Ashtu siç edhe me Ankesën është gjithnjë e rëndësishme të përcaktoni qartë Organin kujt i drejtohet peticioni, objektin konkret që kërkohet, dhe bazën ligjore se ku e bazoni. Mospasja e një prej këtyre elementëve do mund të sillte refuzimin e tij nga ana e administratës, dhe në atë rast do të ishit të detyruar ta ripërsërisnit atë.



### Peticion (Dokument 3)

**Drejtuar:** Institucionit/Bashkisë/Ministrisë Y, (institucioni përgjegjës për zgjidhjen e problemit të komunitetit X)

**Lënda:** Kundërshtim/Ankes/Kërkesë për problemin që shqetëson komunitetin X

**Baza ligjore:** Vendosni ligjin që mbulon fushën për të cilin po zhvillonin peticionin prsh: Ligji Nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, nëse peticioni i drejtohet një Bashkie

l/e nderuar,

Ne pjestarët e komunitetit X dëshirojmë t'ju shprehim me anë të këtij peticioni Kundërshtimin/Ankesën/Kërkesën tonë për veprimet e ndërmarra nga institucioni juaj. Ne kërkojmë që ky peticion, shprehje e vullnetit të një pjese të madhe të komunitetit, të merret parasysh, dhe problemi që ne kemi ngritur të zgjidhet.

Me respekt,  
Antarët e komunitetit X

Emri	Mbiemri	Datëlindja	Vendëlindja	Nr.i letërnjoftimit	Nënshkrimi

## KËRKESË PËR INFORMACION

Gjatë aktivitetit tuaj ju shpesh mund t'ju lindi nevoja për të marr informacione zyrtare për një çështje që ju shqetëson. Një ndihmë e madhe në këtë fushë vjen prej ligjit "Për të drejtën e informimit"<sup>6</sup>, i cili ka vendosur afate konkrete për organet e administratës publike për t'i kthyer përgjigje qytetarëve, duke vendosur masa administrative me gjobë për ata punonjës të administratës të cilët nuk i respektojnë afatet dhe nuk japin informacionin e kërkuar (Dokument 4). Gjithashtu ligji ka krijuar edhe rolin e Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili shërben për ta bërë këtë ligj të zbatueshëm.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucion i pavarur i administratës publike. Ai njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas ligjit "Për të drejtën e informimit" apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara "sekret shtetëror". Me marrjen e një ankimi nga një individ të cilit organi i administratës publike i ka refuzuar ti japi informacion, ose nuk ia ka dhënë atë të plotë, Komisioneri fillon një hetim administrativ i cili nëse përfundon me vërtetimin e faktit për të cilin u bë ankimi, merr masë ndaj punonjësit. Masa e cila mund të jetë gjobë administrative ose paralajmërim. Një kopje të formularit të ankesës ndaj Komisionerit mund ta gjeni në model Dokumenti 5.

<sup>6</sup>"Për të drejtën e informimit", miratuar me ligjin Nr. 119/2014 në datën 18.09.2014



### **KËRKESË PËR INFORMACION** (Dokument 4)

Emër Mbiemër: Z./Znj. \_\_\_\_\_ Adresa postare: \_\_\_\_\_

Adresa elektronike: \_\_\_\_\_ Nr. Tel: \_\_\_\_\_

Data: \_\_/\_\_/201\_\_

Nënshkrimi:

Autoriteti Publik :

Adresa:

Qyteti:

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

---

---

---

Të tjera të dhëna

---

---

---

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:

---

---

---

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: \_\_/\_\_/201\_\_

Numri rendor i kërkesës: \_\_\_\_\_

Komente: \_\_\_\_\_

**FORMULAR ANKESE** (Dokument 5)

Drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Në bazë të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

Emri / Mbiemri : \_\_\_\_\_

Adresa: Qyteti : \_\_\_\_\_

Telefon: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

Autoriteti Publik : \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Qyteti: \_\_\_\_\_

Identifikoni saktë Autoritetin Publik/Institucionin ndaj të cilit ankoheni. Përshtkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Autoriteti Publik dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhni ato.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Përshtkruani çfarë kërkoni nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 119/2014.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

(Data) \_\_\_\_\_ (Firma) \_\_\_\_\_

## KËRKESË PËR DHËNIE VENDIMI KUNDËR DISKRIMINIMIT

Në rast se gjendeni përpara një situatë ku ju ose anëtarë të komunitetit që ju përfaqësoni janë përpara një situatë diskriminimi, ju duhet të veproni duke iu drejtuar me një kërkesë Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Veprimtaria e Komisionerit realizohet nëpërmjet shqyrtimit të ankesave të subjekteve që pretendojnë se janë viktima të sjelljeve diskriminuese apo që e nxisin atë, jo vetëm nga administrata publike, por edhe nga subjektet private. Gjithashtu, Komisioneri realizon hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji, dhe bën sondazhe dhe monitorime për nivelin e zbatimit të ligjit.



Procedurat e hetimit administrativ pasohen nga rekomandime dhe në rast të moszbatimit të tyre vendosen edhe sanksione sipas parashikimeve ligjore. Te gjitha këto shoqërohen me aktivitete që synojnë informimin dhe sensibilizimin e komunitetit, organeve të administratës publike dhe subjekteve private për të nxitur parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Mbasi ju i drejtoheni Komisionerit me një ankesë sipas model Dokumenti 6, ju duhet të merrni një përgjigje brenda 90 ditëve në rast se pas hetimit administrativ kërkesa juaj është pranuar ose jo, dhe se çfarë masash janë marrë ndaj subjektit që ju keni pretendoni se ka ushtruar diskriminim nëse këto pretendime kanë rezultuar të vërteta.

**ANKESË** (Dokument 6)



**Drejtuar:** Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Të dhënat e ankuesit / Grup Personash <sup>1</sup>	Organizatë me interesa legjitime <sup>2</sup>
Emri/Atësia/ Mbiemri _____	Emri i organizatës _____
Datëlindja _____	_____
Profesioni _____	_____
Shtetësi Shqiptar / i huaj _____ a ar	_____
Kombësia _____	Emër/mbiemër i përfaqësuesit _____
Nr.tel/fax _____	_____
Nr.cel _____	_____
E-mail _____	Emër/mbiemër i personit të kontaktit _____
Gjinia F <input type="checkbox"/> M <input type="checkbox"/>	Nr. tel/ fax _____
Adresa _____	Nr. cel _____
Adresa _____	Adresa _____

**PËRMBAJTJA E ANKESËS**

Subjekti që pretendohet të ketë kryer diskriminim ose shpjegimin për pamundësinë e identifikimit të tij

---



---



---

Kur ankesa paraqitet nga një grup personash, formularit do t'i bashkangjitet lista me të dhënat përkatëse.

Ankesa duhet të shoqërohet me kopjen e vendimit për krijimin e organizatës dhe aktin e prokurës së posaçme nëpërmjet të cilit i përfaqësuari, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagrave që i ka dhënë përfaqësuesit.

**Shkaku për të cilin pretendohet diskriminimi**

NR	SHKELJA E PRETENDUAR		SHKELJA E VËRTETUAR	
			PO	JO
1.	<input type="checkbox"/>	Gjinia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	Raca	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	Ngjyra	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	Etnia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	Gjuha	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	Identiteti gjinor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	Orientimi seksual	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	Bindja politike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	Bindja fetare	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	Bindja filozofike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	Gjendja ekonomike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	Gjendja arsimore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	Gjendja shoqerore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	Shtatzënia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	Përkatësia prindërore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	Përgjegjësia prindërore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	Mosha	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

18.	<input type="checkbox"/>	Gjendja familjare	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	Gjendja martesore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	Gjendja civile	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
21.	<input type="checkbox"/>	Vendbanimi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
22.	<input type="checkbox"/>	Gjendja shëndetësore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
23.	<input type="checkbox"/>	Predispozicione gjenetike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
24.	<input type="checkbox"/>	Aftësi e kufizuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
25.	<input type="checkbox"/>	Përkatësia në një grup të veçantë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
26.	<input type="checkbox"/>	Çdo shkak tjetër	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar

\_\_\_\_\_

Masat që kërkohen të ndërmerren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

\_\_\_\_\_

A po shqyrtohet e njëjta çështje në kuadër të një ankese tjetër apo për të është marrë një vendim i mëparshëm?

\_\_\_\_\_

6. Koha kur ka ndodhur diskriminimi

\_\_\_\_\_ (data / muaji / viti)

7. Kur keni marrë dijëni për diskriminimin e pretenduar?

\_\_\_\_\_ (data / muaji / viti)

Numri i dokumenteve (fotokopje) që shoqërojnë ankesën \_\_\_\_\_ copë.

Data e paraqitjes së ankesës \_\_\_\_\_.

### **ANKUESI**

Person/ Grup personash/ Organizatë me interesa legjitime

Emri / Mbiemri / Firma \_\_\_\_\_

## AVOKATI I POPULLIT

Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai ka si mision të tij parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit. Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo Kërkesës së paraqitur pranë tij. Ai vepron edhe me nismën e vet, për raste të veçanta, të bëra publike, por gjithmonë duhet të marrë më vonë pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur apo i paaftë mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.

Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjërë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me Kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative.

Avokati i Popullit nuk vendos direkt vetë për t'i dhënë të drejtat personit që ankohet, por bën rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi i administratës publike që sipas tij ka shkaktuar shkeljen e saj. Në rastet kur organi përkatës nuk reagon ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t'i drejtohet shkallë-shkallë organeve më të larta në hierarki, deri edhe Kuvendit (Parlamentit) me një raport, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

## KONTRATA E VULLNETARIT

Mbas një përpjekje disa vjecare nga ana e Shoqërisë Civile, në Prill të vitit 2016 u miratua ligji “Për punën Vullnetare”<sup>7</sup> me propozimin e dy deputetëve të Kuvendit. Ligji vendos për herë të parë rregulla të qarta se mbi ç’baza kryhet puna vullnetare, kushtet për ta zhvilluar, dhe kufizime që të shmangen abuzimet nga ofruesët e punës vullnetare.

Nëse ju jeni një organizatë ofruese e punës vullnetare, ju duhet të keni parasysh që ligji ju detyron që të gjithë vullnetarët që angazhohen pranë jush duhet të nënshkruajnë kontratën e vullnetarit, e cila duhet të miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e punës, dhe të pajisë vullnetarin brënda 3 ditëve me një kopje të kontratës së sigurimit të shëndetit në rast aksidentesh. Deri në momentin e hartimit të këtij manuali, nuk ka patur asnjë udhëzim në përmbushje të këtij ligji. Ofruesi i punës vullnetare është i detyruar të sigurojë vullnetarët për ato aksidente që ndodhin gjatë kryerjes së punës vullnetare.

<sup>7</sup> LIGJ Nr. 45/2016 PËR VULLNETARIZMIN, miratuar më 28.04.201601

**Kontrata duhet të përmbajë:**

- a) identitetin, vendbanimin ose vendqëndrimin e vullnetarit ose prindit/përfaqësuesit ligjor për vullnetarin e mitur;
- b) numrin personal të identifikimit të vullnetarit ose prindit/përfaqësuesit ligjor për vullnetarin e mitur;
- c) identitetin dhe adresën e ofruesit të vullnetarizmit;
- ç) numrin personal të identifikimit të ofruesit të vullnetarizmit;
- d) identitetin dhe adresën e përfituesit të vullnetarizmit;
- dh) kohëzgjatjen dhe vendin e kryerjes së vullnetarizmit;
- e) përshkrimin e vullnetarizmit që do të kryhet;
- f) të drejtat dhe detyrimet e palëve;
- g) shkaqet dhe mënyrën e zgjidhjes së kontratës;
- h) të dhënat për shpenzimet që kanë të bëjnë me kryerjen e vullnetarizmit dhe mënyrën e kompensimit të tyre.

Një vullnetar nuk mund të punojë më shumë se 5 orë në ditë dhe më shumë se 25 orë në javë. Ofruesi i punës vullnetare duhet t'i ofrojë vullnetarit gjatë kryerjes së punës së tij transport, trajnim, dhe gjithçka mund të nevojitet.

**REGJISTRIMI NË GJYKAT I ORGANIZATAVE JO-FITIMPRURËSE**

Regjistrimi i Organizatave Jo-Fitimprurëse është një proces që ka filluar menjëherë me rënien e komunizmit, pasi përpara asaj periudhe nuk lejohej të kishte organizata që nuk ishin partnere me Partinë e Punës. Vendimi për t'u regjistruar ose jo në formën e një OJF-je ose vazhdimi i angazhimit si një grup informel është një nga vendimet më të rëndësishme.

Arsyet se përse shkohet drejt regjistrimit të një organizate në mënyrë formale janë të shumta, duke përfshirë konsolidimin e strukturës, menaxhim më të mirë financiar, mundësi për të përfituar nga qenia person juridik i cili mbron themeluesit nga përgjegjësitë. Procesi i regjistrimit shpesh herë mund të jetë i komplikuar dhe i vështirë dhe nëse nuk kryhet sic duhet mund t'i shkaktojë organizatës probleme për mirëfunksionimin. Ky nënkapitull do trajtojë vetëm shoqatën, e cila është forma me antarësi e Organizatave Jo-Fitimprurëse, dhe është në të njëjtën kohë forma më e përhapur për shkak edhe të thjeshtësisë së saj.

Numri minimal i antarëve për të regjistruar një shoqatë është 5 persona<sup>a</sup>, të cilët duhet të jenë persona madhor dhe me zotësi për të vepruar. Ligji kërkon që forma e akteve të shoqatës mund të jetë thjesht shkresore, pra pa patur nevojë për të shkohet te noteri, por nga ana praktike sekretaria e Gjykatës, dhe më pas gjykatësi, nuk do ju a pranojnë kërkesën dhe aktet nëse ato nuk do përmbajnë një vërtetim të nënshkrimit nga noteri. Aktet e kërkuara nga ligji për tu hartuar janë Statuti (shih model Dokumenti 7) dhe Akti i Themelimit (shih model Dokumenti 8) të cilat duhen miratuar në mbledhjen e parë të asamblesë përpara se të depozitohen në gjykatë. Gjykata kompetente për regjistrimin e Organizatave Jo-Fitimprurëse është Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, e cila është e vetmja që ka edhe Regjistrin e OJF-ve<sup>a</sup>.

<sup>a</sup> Ligji Nr.8788, datë 7.5.2001 PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE

<sup>a</sup> Ligji Nr. 8789, datë 7.5.2001 PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

**Në mënyrë që të pranohen, statuti i shoqatës duhet të përmbajë:**

- a) formën e organizimit;
- b) emrin, siglën dhe simbolin e veçantë të organizatës;
- c) themeluesit;
- d) qëllimin dhe fushën e veprimtarisë së organizatës;
- e) ndalimin e shpërndarjes së fitimeve;
- f) kohëzgjatjen;
- g) organet drejtuese dhe kompetencat e tyre;
- h) përbërjen e organeve të para drejtuese, që parashikohen në statut;
- i) procedurat dhe mënyrat për zgjedhjen ose ndryshimin e organeve drejtuese;
- j) rregulla për mbajtjen e mbledhjes, pjesëmarrjen, mënyrën dhe procedurën e votimit për marrjen e vendimeve;
- k) kriteret e administrimit të pasurisë;
- l) mënyrën e miratimit të ndryshimit të statudit, të aktit të themelimit dhe të rregullave të brendshme;
- m) rregullat për bashkimin dhe ndarjen e organizatës jofitimprurëse;
- n) mënyrën e përfaqësimit ligjor;
- o) rregullat për likuidimin dhe destinimin e pasurisë pas mbarimit të organizatës.:
- p) rregullat për pranimin e përjashtimit të anëtarëve;
- q) të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve;
- r) rregullat lidhur me kuotizacionet.

Të gjitha këto kriteret mund t'i gjeni në modelin e statudit që i është bashkangjitur këtij Manuali. Akti i themelimit është një dokument më i përmbledhur i cili përmban llojin e organizatës, emrin, selinë, identitetin e themeluesve, qëllimet dhe fushën e veprimtarisë, kohëzgjatjen, emrin e personit që autorizohet të ndjekë procedurat e nevojshme për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse dhe për përfaqësimin ligjor.

Është e rëndësishme të kuptohet se procesi i regjistrimit të një shoqate nuk duhet të fillojë dhe të mbarojë tek gjykata, por shoqata duhet të bëjë një zbatim rigoroz të statudit për të cilin kanë rënë dakort. Një organizatë themelohet për të funksionuar për një kohë të gjatë edhe mbasi themeluesit e saj janë larguar në angazhime të tjera, për këtë arsye është e rëndësishme që të zhvillohen rifreskime të strukturës me anë të zgjedhjeve.

## STATUTI I SHOQATES (Dokument 7) "Rinia"

### Neni 1

#### Forma e organizimit

Shoqata Rinia më poshtë e quajtur "Shoqata", është themeluar në formën e Shoqates në kuptimin e nenit 39 të Kodit Civil .  
Ajo mund të krijojë degë ose filiale në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose dhe jashtë saj.

### Neni 2

#### Emërtimi dhe Selia

Kjo shoqat do të quhet "Rinia".  
Gjat veprimtaris së saj Shoqata mund të përdori gjithashtu edhe emërtimin në gjuhën angleze, "Youth".  
Shoqata ka logon dhe vulen e saj ne form drejtkendore me shkrimin e stilizuar "Rinia"  
Selia e Shoqates do të jetë në adresën nr. X, pallatai 1, apartamenti 2

### Neni 3

#### Themeluesit

Shoqata është krijuar me Aktin e Themelimit të një grup personash me vullnetin dhe iniciativën e lirë të secilit.  
Themelues të Shoqates janë:

### Neni 4

#### Qëllimi dhe fushat e veprimtarisë:

### Neni 5

#### Ndalimi i shpërndarjes së fitimit

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit material e financiar, nga të ardhurat dhe fitimet e Shoqates prej personave që janë subjekte të statutit ose aktit të themelimit, përveç detyrimeve në formën e pagesave, rrogave, shpërblimeve dhe kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të, ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të Shoqates.

### Neni 6

#### Kohëzgjatja

Shoqata krijohet për një afat kohor të pacaktuar .Përfundimi I veprimtarisë bëhet me vendimin e 2/3 të Asambles se te gjithe antareve ose me vendim të Gjykatës së shkallës së parë Tiranë, sipas kushteve të parashikuara në nenin 44 të ligjit "Për Organizatat Jofitimprurëse".

### Neni 7

#### Organet drejtuese dhe kompetencat e tyre

Organe drejtuese të Shoqates janë :  
Asambleja e te gjithe antareve  
Bordi  
Drejtori Ekzekutiv

Kompetencat e organeve drejtuese janë:

#### Kompetencat e Asambles së të gjithë anëtareve

Asambleja eshte organi me i lartë vendimarrës i shoqatës.  
Vendos për ndryshimin e statutit dhe të objektit të veprimtarisë.  
Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë së Shoqatës dhe degëve të saj.  
Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Shoqates dhe shpenzimet.  
Emëron dhe shkarkon Bordin dhe Drejtorin Ekzekutiv.  
Merr vendim për shpërndarjen, bashkimin ose transformimin e Shoqates në një organizatë të një forme tjetër.

Emëron likujdatorët.

Vendos për kalimin e pasurive në subjekte të tjerë në rast shpërndarje të Shoqates.

### **Kompetencat e Bordit**

Bordi është organi vendimarrës në periudhën midis dy Asambleve.

Mbikqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e veprimtarisë së Shoqatës.

Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe administrative.

Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe strukturës organizative të Shoqatës.

Vendos për krijimin e degëve ose filialeve në rrethe ose jashtë vendit.

Vendos për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike nga Shoqata sipas ligjit me qëllim gjenerimin e të ardhurave.

Miraton aktivitetet për mbledhjen e fondeve , sipas nenit 37 të ligjit

“Për Organizatat Jofitimprurëse”.

Shqyrton raportin e likujdatorëve.

Pranon anëtarët e rinj në Shoqatë.

### **Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv**

Drejtori Ekzekutiv është organi me i lart ekzekutiv i shoqates. Ai ka të gjitha kompetencat e nevojshme për administrimin e veprimtarisë së përditshme të Shoqates, në zbatim të statutit, vendimeve të Bordit dhe legjislacionit në fuqi. Drejtori Ekzekutiv raporton dhe jep llogari përpara Bordit dhe asambles sa herë që i kërkohet.

Drejtori Ekzekutiv lidh kontratat e punës me stafin e Shoqates, duke përdorur metodën e konkurimit të hapur e të lirë, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi.

### **Neni 8**

#### **Përbërja e organeve të para drejtuese**

Bordi I parë:

Drejtor i parë Ekzekutiv është John Doe.

### **Neni 9**

#### **Procedurat dhe mënyrat për zgjedhjen ose ndryshimin e organeve drejtuese**

Anëtarët e Bordit Drejtues zgjidhen për një mandat X vjeçar nga asambleja e të gjithë antareve me shumicë të thjeshtë të antareve në asamble.

Drejtori Ekzekutiv zgjidhet antari që ka marrë më shumë vota nga kandidatët, për një mandat X vjeçar. Nëse arrihet në balotazh, bëhet një votim i dytë vetëm për kryetarin midis dy personave që kanë marrë numër të barabart votash ku secili antar ka të drejtën e vetëm një vote.

Drejtori Ekzekutiv mund të shkarkohet para mandati vetëm me vendim të Asamblesë së të gjithë antareve.

### **Neni 10**

#### **Rregullat për mbajtjen e mbledhjeve**

Asambleja e të gjithë antareve mbledhet si rregull një herë në vit. Ajo mund të thirret në mbledhje të jashtëzakonshme kur këto e kërkon shumica e bordit ose 1/3 e të gjithë antareve

Mbledhja e Bordit thirret kur e kërkon Drejtori Ekzekutiv ose dy anëtarë të Bordit.

Mbledhja njoftohet me shkrim të paktën shtatë ditë përpara duke bërë të ditur datën, orën, vendin e zhvillimit të saj dhe rendin e ditës.

### **Neni 11**

#### **Antarsia**

Cdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç mund të kërkojë të bëhet antarë i shoqatës “Rinia”. Pranimi i tij bëhet me vendim nominal të Bordit të shoqatës.

Antari mund të përjashtohet me kërkesë të kryetarit kur nuk është kryer pagesa e kuotizimit me shumë se një vit, shkelje të rregullores së brendshme, ose nga akte që demtojnë rendin imazhin e shoqatës



### **Neni 12** **Vendimarrja**

Asambleja i merr vendimet e saj me shumicë të thjeshtë të antareve përveçse kur në këtë statut thuhet ndryshe.

Vendimet e Bordit merren me votën pro të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i fshehtë, por në raste të veçanta Bordi mund të vendosë edhe ndryshe.

Çdo vendim i Bordit dhe procesverbalet përkatëse të mbledhjeve nënshkruhen nga Kryetari i Bordit. Një punonjës i stafit, i caktuar nga Kryetari i Bordit kryen detyrën e sekretarit teknik të Bordit.

### **Neni 13** **Kriteret e administrimit të pasurisë**

Administrimi i pasurive të Shoqates bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe financiare mbahet bilanc i rregullt, që miratohet nga Bordi.

Shoqata ka llogaritë e saj bankare, që çelen dhe operojnë sipas urdhërave të Drejtorit Ekzekutiv.

Bordi, ka të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shpjegime rreth gjendjes financiare të Shoqates dhe Drejtori me stafin i japin ato brenda një afati optimal dhe nëse është e nevojshme i shoqëronë këto shpjegime me fotokopjet e dokumentacionit përkatës.

### **Neni 14** **Ndryshimet në Statut dhe Aktin e themelimit**

Ndryshimet në Statutin e Shoqates dhe Aktin e themelimit bëhen vetëm me vendim të Asamblesë së të gjithë antareve.

### **Neni 15** **Destinimi i pasurisë pas mbarimit të Shoqates**

Në rast se për arsye të parashikuara në këtë Statut, ose çdo arsye tjetër të ligjshme, Shoqata ndërpret veprimtarinë e saj, të gjitha pasuritë e mbetura të saj i kalojnë me vendim të Asamblesë së të gjithë antareve një organizatë tjetër që ka të njëjtin aktivitet.

### **Neni 16** **Rregullat për bashkimin dhe ndarjen e Shoqates**

Bashkimi i Shoqates me ndonjë subjekt tjetër jofitimprurës bëhet me vendim të Asamblesë së të gjithë antareve, gjithmonë duke zbatuar kërkesat e Kodit Civil dhe ligjeve "Për Organizatat Jofitimprurëse" dhe "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse".

### **Neni 17** **Përfaqësimi ligjor**

Përfaqësues ligjor i Shoqates është Drejtori Ekzekutiv.

Nëse ai për arsye të ndryshme nuk është i disponueshëm, ia kalon këtë të drejtë një punonjësi tjetër të Shoqates me anë të një autorizimi, ku përcakton shprehimisht kompetencat që ka deleguar dhe shtrirjen kohore të vlefshmërisë së delegimit.

### **Neni 18** **Burimet financiare e materiale, mënyra e përdorimit të tyre**

Burimet financiare dhe materiale të Shoqates janë:

Kuotizacioni vjetor i antareve, ku shume dhe mënyra e pagesës vendoset me vendim të Bordit

grante dhe donacione të ofruara nga subjekte private dhe publike, vendas ose të huaj të ardhura nga veprimtaria ekonomike në përputhje me ligjin, sipas miratimit të Bordit të ardhura nga pasuritë në pronësi të Shoqates.

Veprimtaria ekonomike

Të gjitha shpenzimet bëhen për realizimin e qëllimit dhe objektivave të Shoqates si dhe për mirëmbajtjen e pasurisë së saj.

### **Neni 19 Likuidimi**

Kur vendoset shpërndarja e Shoqates, Asambleja cakton një ose disa likuidatorë, të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi asetet, pasuritë dhe përfaqësimin e Shoqates që nga data e emërimit të tyre e deri në përfundim të likuidimit.

Likuidatorët e kryejnë veprimtarinë e tyre në baze të nenit 47 të ligjit “Për Organizatat Jofitimprurëse” dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Kur shpërndarja e Shoqates vendoset me vullnet të lirë të Asambles se te gjithë antareve, Bordi miraton dhe raportin përfundimtar të likuidatorit dhe kërkon nga gjykata kompetente çregjistrimin e Shoqates. Nëse raporti përfundimtar i likuidatorëve nuk miratohet nga Bordi, shqyrtohet nga gjykata në prani të palëve.

### **Neni 21 Hyrja në fuqi e statutit**

Ky statut hynë në fuqi me rregjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Tiranë, të Shoqates.

Për Shoqaten “Rinia”

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_

## **AKTI I THEMELIT (Dokument 8) I SHOQATËS**

### **“Rinia”**

Në mbështetje të ligjit Ligjit nr.8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, Ligjit nr.8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, nenet 39-53 të Kodit Civil hartohet ky akt-themelimi i shoqatës “Brave Neë Generation”. Kjo shoqatë është një organizatë jofitimprurëse, e krijuar me vullnetin e lirë e të plotë të anëtarëve themelues:

### **Neni 1 Emërtimi i Shoqatës**

Emërtimi i shoqatës është “Rinia”. Gjithashtu organizata mund të përdori edhe emërtimin e saj në gjuhën angleze “Youth”

Rinia është e organizuar në formën e një shoqate, jo-fitimprurëse, jo-qeveritare, jo-politike, që e ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërore.

### **Neni 2 Qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së fushatës**

### **Neni 3 Selia e Shoqatës**

Selia qendrore e Shoqatës do të jetë në adresën \_\_\_\_\_. Veprimtaria e saj mund të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

### **Neni 4 Përfaqësimi**

Shoqata ka autorizon të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme të regjistrimit të shoqates John Doe

### **Neni 5 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqatës është e pakufizuar. Në çdo rast Shoqata mund ta mbyllë veprimtarinë e saj sipas kritereve të parashikuara në statut.

### **Neni 6**

Ky akt-themelimi pasi miratohet dhe nënshkruhet nga themeluesit e Shoqatës paraqitet në Gjykatë për miratim dhe depozitohet në Rregjistrin e Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë. Regjistrimi i Personit Juridik të shoqatës "Rinia" bëhet në datën e regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

### **THEMELUESIT**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_

## **PADIA ADMINISTRATIVE NGA NJE SHOQATE OSE GRUP INTERESI**

Me ngritjen e Gjykatës Administrative në vitin 2013<sup>10</sup>, shoqatave dhe grupeve të interesit iu lindi një e drejtë që më parë ishte shumë e vështirë për t'u ushtruar, ajo e ngritjes së padisë për çështje që prek interes publik. Që dikush të ketë të drejtën për të ngritur një padi, ai duhet të vërtetojë se ka një interes të ligjshëm për çështjen në fjalë, dhe kjo ishte shumë e vështirë për t'u realizuar nga organizatat përpara se ligji ta jepte këtë përcaktim.

Pavarsisht pasjes së kësaj të drejte, në rast se ju konstatoni një akt administrativ që bie në kundërshtim me një interes legjitim të komunitetit të cilin ju përfaqësoni, këshillohet gjithmonë që të merrni një avokat të specializuar në çështjet administrative për të formuluar padinë që do paraqitet në gjykat si dhe për ta ndjekur më pas çështjen. Ky nënkapitull shërben vetëm për t'ju informuar mbi ekzistencën e kësaj mundësie, dhe në ndryshim nga nënkapitujt e tjerë nuk do ofrojë një Dokument model, mbi formën që duhet të kishte në këtë rastë padia administrative.

Kjo padi mund të ngrihet qoftë për të kundërshtuar një një akt administrativ individual, si edhe një akt administrativ normativ. Nëse akti në fjalë rregullon një çështje të vetme, pavarsisht sa persona janë të përfshirë është akt individual, ndërsa nëse i njëjti akt rregullon çështje të ngjashme ai është një akt normativ. Dallimi është i nevojshëm për shkak se kundërshtimi i akteve normative duhet bërë në Gjykatën Administrative të Apelit, ndërsa kundërshtimi i atyre individuale bëhet fillimisht në gjykatën e shkallës së parë.

<sup>10</sup> PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATAVE ADMINISTRATIVE DHE GJYKIMIN E MOSMARREVESHJEVE ADMINISTRATIV, LIGJ Nr. 49/2012

## REGJISTRIMI NE TATIME

Organizatat jofitimprurëse regjistrohen në administratën tatimore, pasi kanë kryer më parë regjistrimin, në përputhje me legjislacionin e fushës. (Themelimi, Regjistrimi në Gjykatë)

Dokumentat që paraqiten për regjistrim në Drejtorinë e Tatimeve sipas udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", janë si më poshtë:

- Vendimin e Gjykatës, Statutin dhe Akt-Themelimin e noterizuar;
- Fotokopje të Kartës së Identitetit ose të Pasaportës së administratorit apo përfaqësuesit ligjor;
- Të dhënat për pronësinë e selisë (kontratë qiraje ose akt pronësie);
- Formularin e regjistrimit të plotësuar.

Pas marrjes së certifikatës së NIPT-it subjekti pajiset dhe me fjalëkalimin që do të shërbejë për deklarimin online. Në rastet kur Drejtoria e Tatimeve konstaton se një organizat jo-fitimprurëse ushtron aktivitet pa u regjistruar pranë organeve tatimore, ajo penalizohet nga administrata tatimore sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë". Duhet pasur gjithmonë kujdes mbas regjistrimit në organet tatimore dhe pajisjes me NIPT për t'u siguruar se cilat deklarime duhet të bëni, dhe t'i kryeni ato brenda afatit në mënyrë që të shmangni gjokat për mosdeklarim të cilat do ju penalizonin në veprimtarinë tuaj. Është gjithnjë e këshillueshme të keni një person më njohuri të posaçme në mbajtjen e financave në mënyrë që të garantoni mospasjen e problemeve me organet tatimore.

## NISMA LIGJORE QYTETARE DHE REFERENDUMET

Demokracia është krijuar kur votimi zhvillohej vetëm brenda një qytet-shteti dhe ku numri i subjekteve që lejoheshin të votonin ishte aq i vogël sa mund të zhvilloheshin votime të drejtpërdrejta për çdo çështje. Me krijimin e shteteve më të mëdha, u krijua nevoja që disa vendim-marrje të delegoheshin në një numër më të ngushtë individësh duke krijuar kështu demokracinë përfaqësuese. Në kohët moderne demokracia e drejtpërdrejtë ka marrë formën e referendumeve, ku të gjithë votuesve i kërkohet të shprehen në lidhje me një çështje që është thjeshtuar në një pyetje me përgjigje po ose jo.

Në Shqipëri referendumet janë parashikuar në Pjesën 11 të Kushtetutës, e cila parashikon të drejtën e 50 mijë zgjedhësve për të kërkuar një referendum për shfuqizimin e një ligji, ose për t'i kërkuar Presidentit zhvillimin e referendumit për një çështje të veçantë. Gjithashtu e deputetëve ka të drejtë t'i kërkojë Kuvendit që një ligj i veçantë të miratohet me referendum.

Nga ana praktike Kushtetuta e ka kufizuar të drejtën e 50 mijë zgjedhësve për të kërkuar vetëm shfuqizimin e ligjit, por jo miratimin e një ligji të ri, pasi të drejtën që një ligj të miratohet me referendum e ka vetëm Kuvendi. Pavarësisht kësaj Kushtetuta ka parashikuar një mekanizëm tjetër për të kontribuar në demokracinë e drejtpërdrejt, të drejtën e 20 mijë zgjedhësve për të propozuar një ligj.

Asaj që shpesh i referohen si nisma ligjore qytetare, është e drejta e parashikuar në nenin 81 të Kushtetutës që 20 mijë zgjedhës të mund të propozojnë një ligj, i cili më pas i nënshtrohet procedurës normale parlamentare duke mos garantuar si proces miratimin e tij. Procesi i propozimit të një ligji nga ana e zgjedhësve në ndryshim nga peticioni, i shpjeguar në nënkapitujt e mëparshëm, është një proces që është i rregulluar nga Kushtetuta dhe monitorohet nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve duke i dhënë një tjetër rëndësi procedurës së ndjekur.

Legjislacioni që zbatohet qoftë për Referendum, ashtu edhe për ligjet e propozuara nga zgjedhësit është i vakët dhe i debatueshëm. Kodi aktual zgjedhor nuk i përmend fare, dhe për pasojë zbatohen dispozitat e Kodit Zgjedhor të vitit 2003, të cilat knjojnë vështirësira të mëdha për grupin nismëtar. Për të nisur procedurat e një referendumi ose nisme ligjore qytetare duhet krijuar një komision nismëtar i përbërë nga 12 persona të cilët plotësojnë kriteret për të qënë zgjedhës. Komisioni nismëtar duhet të depozitohet pranë KQZ kërkesën e cila përmban në mënyrë të qartë ligjin ose pjesën e ligjit që kërkohet të shfuqizohet në rastin e referendumit, si dhe formulimin e pyetjes që do i drejtohet zgjedhësve nëse kryerja e referendumit do lejohet, ose një kopje të ligjit që propozohet në rastin e nismës ligjore.

KQZ mbasi verifikon kriterët e komisionit nismëtar, i pajis ata kundrejt pagesës me formularë për të mbledhur firmat e zgjedhësve të cilët mbështesin kërkesën për zhvillimin e referendumit, ose propozimin e ligjit. Zgjedhësit të cilët firmosin në formular duhet gjithashtu të japin një fotokopje të kartës së tyre të identitetit të firmosur në mënyrë që të garantohet saktësia e firmave dhe identiteti i zgjedhësve. Mbasi të jenë mbledhur më shumë firma se minimumi i kërkuar nga ligji, komisioni nismëtar bën depozitimin e firmave, ku periudha e vetme e lejuar është muaji Nëntor-Dhjetor. KQZ brenda datës 15 Mars bën verifikimin e firmave duke kontrolluar saktësinë e 5% të totalit të firmave të dorëzuara. Nëse mbasi janë zbritur firmat e parregullta numri i firmave vazhdon të jetë mbi minimumin e kërkuar KQZ vendos dërgimin e kërkesës për referendum pranë Gjykatës Kushtetuese e cila bën verifikimin e kushtetueshmërisë së kërkesës për referendum, dhe dërgimin ligjit të propozuar pranë Kuvëndit në rastin e nismës ligjore qytetare. Të dy këto mekanizma të demokracisë së drejtpërdrejtë kërkojnë shumë kohë dhe mund për t'u realizuar, dhe për këtë arsye ato janë përdorur shumë rrallë në Shqipëri, ku ende nuk kemi patur një referendum të zhvilluar me kërkesën e 50 mijë zgjedhjeve. Shumë aktivistë zgjedhin që nëvend të ndjekjes së kësaj rrugë të bëjnë advokim të drejtpërdrejtë tek përfaqësuesit e zgjedhur, si një metodë shumë më e shpejtë dhe pa kosto.



## KAPITULLI III

### PROFILET E ORGANIZATAVE



#### **Shoqata NEW BRIDGES BERAT**

**Adresa:** Lagjja "18 Tetori", Rruga " 4 Dëshmorët", Pall 8-katësh, apt 19.

**Struktura e organizatës:** Asambleja e përgjithshme, Bordi, Kryetari i shoqatës, Menaxher projekti, Financier, Staf, Vullnetarë.

**20 Vullnetarë: 11 vajza dhe 9 djem.**

#### **Programet kryesore të shoqatës "New Bridges Berat" do të përfshijnë:**

1. Ndërgjegjësim dhe edukim;
2. Avokimi dhe Lobimi.
3. Iniciativa komunitare

**Drejtor Ekzekutiv :** Zoica Bardhi

**Tel:** 0693577652

**Email:** zoica.bardhi@gmail.com ; uretereja@gmail.com

<https://www.facebook.com/newbridgesberat/>

New Bridges Berat është një organizatë e themeluar në vitin 2017, në qytetin e Urës Vajguore, në qarkun Berat. Themelimi i organizatës lindi si nevojë e mungesës së aktiviteteve dhe programeve të ndryshme për të rinjtë, por edhe për adresimin e problematikave të komunitetit kundrejtë aktorëve lokale. Shoqata "Urat e Reja" synon fuqizimin e komunitetit për pjesëmarrje në jetën ekonomike-sociale në nivel vendor nëpërmjet ndërgjegjësimit, programeve edukuese dhe iniciativave komunitare dhe advokuese.

1- Kampi veror i lidërshiptit 2017. Për herë të parë në qytetin e Urës Vajguore u zhvillua kampi i veror për të rinjtë. U punua me të rinjtë lokale për t'i ndihmuar në promovimin e lidërshiptit në komunitet. U përdoren aktivitete të ndryshme dhe lojra për të zhvilluar dhe promovuar punën në grup, bashkëpunimin dhe vullnetarizimin në komunitet.

2- Projekti "Guroret, Lobim, Advokim, krijimi i grupeve ekologjie" me qëllim përmirësimin e ndotjes së ajrit në komunitet. U trajnuan rreth 60 persona për lobim dhe advokim për adresimin e çështjeve mjedisore.

- 3- Projekti "Guroret, Lobim, Advokim, krijimi i grupeve ekologjike" me qëllim përmirësimin e ndotjes së ajrit në komunitet. U trajnuan rreth 60 persona për lobim dhe advokim për adresimin e çështjeve mjedisore.
- 4- Qytetar Aktiv – Projekti i ndërgjegjësimit të komunitetit për mbrojtjen e mjedisit nga hedhja pa kriter e mbetjeve urbane. Projekti u zbatua nga dy shkolla.
- 5- Ditët kundër dhunës me bazë gjinore – u punua me një grup prej 15 nxënësish duke u fokusuar në parandalimin e dhunës në shtëpi dhe komunitet.
- 6- Krijimi i grupeve lokale të grave – diskutime me gratë e komunitetit për të adresuar problemet që janë në komunitet dhe adresimin e tyre në institucionet përkatëse.



**GRUPIMI****5 Plus**

E-mail : grupimi5plus@gmail.com

**Struktura e organizatës:** Ky grup informal është themeluar nga 5 persona.  
**Numri i aktivistëve:** 30 persona, të specifikuar në 15 vajza dhe 15 djem të moshës 14-20 vjec.

**Grupimi informal “5 PLUS”** është një grup i formuar në qytetin e Cërrikut.

**Adresa:** Lagjja Nr. 2 i vendosur pranë shkollës 9-vjecare “Aleks Buda”.

**Si partner të përkohëshëm në punën tonë vecojmë :**

- IDM, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
- KKR, Kongresi Rinor Kombëtar
- Rrjeti Youth Voice
- UNFPA Albania

**Email:** grupimi5plus@gmail

**Facebook:** Grupimi 5 Plus

**Historik i Grupimit**

Grupimi 5+ është finalizim i shumë diskutimeve, ideve dhe nismave të menduara si një nevojë emergjente për të sjellë dicka ndryshe në një komunitet të vogël si Cërriku por dhe më gjerë. Si rezultat i kësaj dëshire një grup prej 5 të rinjsh /individësh u mobilizuan dhe i dhanë formë ideve të tyre për t'i sjellë kësaj shoqërie një imazh pozitiv ku njerëz inovator, të ndryshëm, por me dëshirë për të përballur sfida, mund të sjellin impakt dhe ndryshim në mentalitet edhe në përmirësimin e mënyrës së të jetuarit shëndetshëm.

Ky grupim informal i përbërë nga pjesëmarrës dhe aktiviste të rinj synon që punën e tij ta ndërtoj duke u mbështetur në disa ide dhe koncepte bazë, të cilat në vijimësi do të kthehen dhe në bazat e forta të punës sonë, për ta kthyer këtë iniciativë në një risi të suksesshme edhe efektive për përmirësimin e jetes në komunitetin ku ne bëjmë pjesë.

Si datë e fillimit të aktiviteteve për Grupimin “5 Plus” është dt. 1 tetor 2017, aktiviteti i parë që shënoi dhe themelimin e aktiviteteve të këtij grupi të rinjsh. Ky aktivitet u zhvillua nga 10 të rinj aktiviste të Grupimit tonë dhe aktiviteti u zhvilluan në kuadër të Ditës Botërore të Moshës së Tretë. Për çdo javë në ambientet e grupimit zhvillohen trajnime, debate dhe diskutime grupi me tematika të ndryshme. Është shumë i rëndësishëm angazhimi dhe dëshira e të rinjve për të punuar dhe për të sjellë optimizëm në një qytet të vogël si Cërriku.

Baza e punës sonë nisi me aktivizim qytetar, aktivizim që ishte i lidhur ngushtësisht me motivim human për të bërë gjëra të vogla por që brenda kishin jetë dhe përconin humanizëm. Ky grupim që synon risitë me nisma e aktivitete kërkon të përcoj frymë ndryshimi pozitive dhe demokracie sociale për të gjithë shtresat pa përjashtim. Por sigurisht duke pasur si elementë bazë të punës sonë, të rinjtë e një qyteti të vogël si Cërriku po dhe më gjerë.



## Iniciativa më e suksesshme e Grupimit “5 Plus”

Iniciativa dhe nisma më e suksesshme e Grupimit “5 Plus” është planifikimi, filmimi dhe montimi i një video mesazhi të menduar dhe implementuar nga 3 themelues të këtij grupimi për të marrë pjesë në konkursin me temë: “Unë besoj”. Qëllimi i kësaj videoje ishte përcimi i frymës së besimit të rinisë për të ndryshuar këtë vend, për të besuar në institucione dhe në fuqinë e fjalës, mendimit e veprimit të tyre, si pjesa më vitale e shoqërisë. Kjo video pati një shpërndarje masive në rrjetet sociale, impakti i saj ishte shumë pozitiv dhe mesazhi u përcoll duke qenë zëri dhe mendimi i cdo të riu me dëshira dhe aspirata për të punuar për këtë vend.

Më poshtë linku i videos:

<https://www.facebook.com/grupimi5plus/videos/2031351717147707>

### Foto nga aktivitetet e Grupimit “5 Plus”







## **Shoqata “UDHËTIM I LIRË LIBERI DI VIAGGIARE”**

është një organizatë joqeveritare që operon në Durrës që nga viti 2015.

Stafi ynë ka një përvojë shumë vjeçare në shoqërinë civile veçanërisht me rininë.

**Numri i aktivistëve:** 9 vajza dhe 8 djem.

### **Shoqata ka mundësuar anëtarësimin në disa rrjete OJF-sh si:**

1. Fondacioni Anna Lindth
2. Kongresit Rinor Kombëtar
3. Dita e Tokës (Earth Day Netëork)
4. Platformës së Bashkëpunimit Rinor të Ballkanit Perëndimor.

### **Shoqata ka nënshkruar programe bashkëpunimi me:**

1. Bashkitë Durrës e Shijak,
2. Këshillin e Qarkut Durrës,
3. Drejtorinë Arsimore Durrës
4. Shkollat e Mesme të Përgjithshme Naim Frasheri dhe Gjergj Kastrioti në Durrës.

**Adresa:** Rruga Egnatia 2001, Lagja 3, Durres.

**Email:** udhetimilire@gmail.com

**Tel:** ++355 52 237860

**FB:** Udhëtimi Lire

### **Mini historik i organizates**

Shoqata “Udhëtim i lirë –Liberi di viaggiare (Uil-LdV)” është krijuar në qershor të vitit 2015 me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Uil-LdV është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, joqeveritare, jopolitike, e cila nuk ndjek qëllime fitimi dhe është e hapur për të gjithë ata që punojnë për realizimin e qëllimeve të saj. Ndonëse e krijuar para pak vitesh, Uil-LdV po bën përpjekje serioze të shndërrohet në një faktor për arritjen e ndryshimeve të qëndrueshme dhe pozitive në Qarkun e Durrësit, duke vënë theksin në çështjet e zhvillimit të turizmit, promovimit të vlerave historike, trashëgimisë e kulturës vendase, zhvillimit të teknologjisë dhe mbrojtjes së mjedisit, promovimin e të rinjve. Që nga krijimi, përmes aktiviteteve të rritjes së kapaciteteve, nismave edukative, avokuese dhe informuese, shoqata Uil, është shndërruar në një faktor të rëndësishëm të shoqërisë civile në Qarkun e Durrësit. Ajo ka qëllime të qarta të lidhura me krijimin e partneriteteve me organizata me të njëjtin fokus, me anëtarësimin në rrjete rajonale, promovimin tek donatorët, zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve që synojnë edukimin dhe zhvillimin e komuniteteve lokale si dhe në realizimin e aktiviteteve me impakt të drejtpërdrejtë në mjedis, edukimin e brezit të ri, dhe promovimit të turizmit përmes artit nga të rinjtë.

### Aktivitete të realizuara

Historiku relativisht i ri i shoqatës nuk ka qenë faktor frenues në zbatimin e aktiviteteve të shumta lokale dhe kombëtare, një pjesë e të cilëve janë mundësuar falë mbështetjes së ofruar nga Bashkia Durrësit. Aktivitetet të tilla, përfshijnë:

- Eventet për ndërgjegjësimin publik për Ditën e Tokës më 22 prill 2016 dhe 2017, të organizuara në bashkëpunim me Rjetin Earth Day Netëork, me Bashkinë e Durrësit dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR).
- Ekspozitat e fotografive "Durrës 2016", "Talent 2016", "Turizmi i Qën drueshëm 2017" dhe "Gavril Priftuli 2017", të organizuara me nxënës të shkollave të mesme të Qarkut Durrës, në bashkëpunim me Bashkinë e Durrësit dhe DAR.
- Java e Lëvizshmërisë, 17 - 22 Shtator 2017 në bashkëpunim me Bashkinë e Durrësit dhe OJQ të tjera në Durrës, nën kujdestarinë e Delegacionit të BE-së në Tiranë.
- Tryeza e rrumbullakët për negociimin e Shqipërisë me rolin e KE-së në këtë proces, organizuar në Këshillin Bashkiak të Durrësit - në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar dhe Bashkinë e Durrësit.
- Konferenca: "Një hap përpara së bashku" në kuadër të Rezolutës së të Rinjve, organizuar në Pallatin e Kulturës në Durrës - në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar dhe Bashkinë e Durrësit.

Gjatë punës sonë mund të vemë theksin në aktivitetet e kryera në kuadër të projektit "Youth Eco Act", mbështetur nga Grantet Operacionale të programit "Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile" në fushën e Mjedisit në Shqipëri (SENIOR-II) që zbatohet nga REC - "Qendra Rajonale e Mjedisit në Shqipëri", mbështetur dhe financuar nga Ambasada Suedeze në Tiranë.

Të rinjtë e 5 shkollave të mesme të qytetit të Durrësit janë trajnuar për çështjet mjedisore dhe ky informacion kulmoi me ekspozitën "Turizmi dhe Riciklimi" zhvilluar me datë 18-22 Prill 2018 si pjesë integrale e Nismës "Unë ricikloj" të prezantuar në fillim të projektit nga stafi. Gjithashtu të rinjtë vullnetarë po ndjekin një cikël 12 mujor trajnimesh me tema të ndryshme për të rritur kapacitetet e tyre. Në kuadër të kësaj nisme janë vendosur gjithashtu koshat për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve, në sitet arkeologjike të qytetit të Durrësit punuar me material të ricikluar.

Pas përvojës pozitive të këtij projekti që mbulon vetëm 5 shkollat e mesme të qytetit tashmë me mbështetjen e Raiffeisen Invest po e shtrijmë këtë iniciativë edhe në 4 shkollat e mesme periferike të Durrësit.

## Shoqata “NJERËZIT TË PARËT”

**Adresa:** Rr. “Jakov Xoxa”, Nd.35/1, H.2, Fier

**Numri i aktivisteve:** 14 të rinj aktivistë (7 vajza dhe 7 djem) të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në aktivitete apo nismat që ajo drejton.

**cel:** +355 69 53 91 565

**Email:** pefi.contact@gmail.com

**Fb:** People First Association

Misioni i saj është të inkurajoi një shoqëri të përgjegjshme, të informuar dhe të angazhuar drejt parimeve demokratike duke ndjekur filozofinë e forcimit të të drejtave të njeriut nëpërmjet edukimit dhe aftësimin. Asamblesja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës.

### **Gjatë vitit 2017 dhe në vazhdim, “Njerëzit e Parët” ka zbatuar dy programe kryesore:**

1- Programin e Mbështetjes së Bizneseve i cili synon ngritjen e bizneseve të reja në rajonin e Fierit ose mbështetjen e bizneseve të ngritura në fusha të ndryshme, si dhe në bujqësi. Projekti mbështetet nga kompania Bankers Petroleum Albania LTD.

2- Programi i Mësimin të Gjuhës Angleze i cili synon mbështetjen e 80 fëmijëve nga familje me të ardhura të pakta, komunitetet e marxhinalizuara apo vulnerable për të përmirësuar aftësitë në gjuhën Angleze dhe për tu ekspozuar ndaj kulturës, stilit të jetesës dhe parimeve të demokracisë Amerikane. Projekti mbështetet nga Zyra e Marrëdhënive me Publikun e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Përveç këtyre programeve, organizata realizon vazhdimisht aktivitete dhe fushata edukimi, informimi dhe ndërgjegjësimi në sektorë të ndryshëm. Fushata për focimin e pozitës së gruas gjatë 8-marsit është kthyer në një traditë tashmë, se cilës cdo vit i bashkohen më shumë gra dhe vajza. Java Evropiane Kundër Racizmit, Barazi në Vendimmarrje, “Ëelcome home, my friend”, “Put your start-up in motion”, “Nisma për lehtësimin e strehimit social në qytetin e Fierit” janë vetëm disa ndër projektet e suksesshme gjatë 2017, të cilat janë në rrugë të mbarë për t’u zbatuar sërish

### **Aktivitete të realizuara**

Historiku relativisht i ri i shoqatës nuk ka qene faktor frenues në zbatimin e aktiviteteve të shumta lokale dhe kombëtare, një pjesë e të cilëve janë mundësuar falë mbështetjes së ofruar nga Bashkia Durrësit. Aktivitetet të tilla, përfshijnë:

- Eventet për ndërgjegjësimin publik për Ditën e Tokës më 22 prill 2016 dhe 2017, të organizuara në bashkëpunim me Rjetin Earth Day Netëork, me Bashkinë e Durrësit dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR).

- Ekspozitat e fotografive "Durrës 2016", "Talent 2016", "Turizmi i Qën drueshëm 2017" dhe "Gavril Priftuli 2017", të organizuara me nxënës të shkollave të mesme të Garkut Durrës, në bashkëpunim me Bashkinë e Durrësit dhe DAR.
- Java e Lëvizshmërisë, 17 - 22 Shtator 2017 në bashkëpunim me Bashkinë e Durrësit dhe OJQ të tjera në Durrës, nën kujdestarinë e Delegacionit të BE-së në Tiranë.
- Tryeza e rumbullakët për negocimin e Shqipërisë me rolin e KE-së në këtë proces, organizuar në Këshillin Bashkiak të Durrësit në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar dhe Bashkinë e Durrësit.
- Konferenca: "Një hap përpara së bashku" në kuadër të Rezolutës së të Rinjve, organizuar në Pallatin e Kulturës në Durrës - në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar dhe Bashkinë e Durrësit.

Gjatë punës sonë mund të vemë theksin në aktivitetet e kryera në kuadër të projektit "Youth Eco Act", mbështetur nga Grantet Operacionale të programit "Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile" në fushën e Mjedisit në Shqipëri (SENIOR-II) që zbatohet nga REC - "Qendra Rajonale e Mjedisit në Shqipëri", mbështetur dhe financiar nga Ambasada Suedeze në Tiranë.

Të rinjtë e 5 shkollave të mesme të qytetit të Durrësit janë trajnuar për çështjet mjedisore dhe ky informacion kulmoi me ekspozitën "Turizmi dhe Riciklimi" zhvilluar me datë 18-22 Prill 2018 si pjesë integrale e Nismës "Unë ricikloj" të prezantuar në fillim të projektit nga stafi. Gjithashtu të rinjtë vullnetarë po ndjekin një cikël 12 mujor trajnimesh me tema të ndryshme për të rritur kapacitetet e tyre. Në kuadër të kësaj nisme janë vendosur gjithashtu koshat për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve, në sítet arkeologjike të qytetit të Durrësit punuar me material të ricikluar.

Pas përvojës pozitive të këtij projekti që mbulon vetëm 5 shkollat e mesme të qytetit tashmë me mbështetjen e Raiffeisen Invest po e shtrijmë këtë iniciativë edhe në 4 shkollat e mesme periferike të Durrësit.





## GRUPI ATA

**Adresa:** Qendra Rinore ATA, Rr. “Stokholm”, Bulevardi Blu, Kamëz

**Struktura:** Grupi joformal aktivistësh në qytetin e Kamzës

**Numri i Aktivistëve:** 15

**Fushat kryesore të veprimit:** Kulturë dhe Edukim

**Partneritetet:** Lëviz Albania; Ministria e Kulturës,

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Fondacioni FES, Kongresi Rinor, EU Policy Hub etj

**Kontaktet:** grupiata1@gmail.com;

**facebook:** Faqja zyrtare e grupit ATA; instagram: grupi\_ata

**website:** Nyje. Al (<http://nyje.al/ata/ata/>)

### Historia e Grupit ATA

ATA është një grup joformal aktivistësh që ka filluar veprimtarinë e tij që në maj të vitit 2014 në Kamëz. Të rinj të qytetit me formim në drejtësi, gazetari, mjeksi dhe ekonomi besojnë në kulturë dhe në art si mundësi për të imagjinuar dhe projektuar përtej limiteve që të vendos periferia. Për grupin ATA aktivizëm do të thotë të shkojë përtej (për)kufizimeve dhe të gjejë një mënyrë të përbashkët reagimi për publikun, për tjetrin, për veten. ATA herë ka trajtën e një grupi, herë të një procesi, një lëvizjeje, një praktike jetësore. Nëpërmjet akteve performative, trajnimeve me metoda jo formale me tematikë ligjin dhe të drejtat e njeriut, nismave edukuese për të krijuar një hapësirë kulturore dhe intelektuale në qytet, synojnë që të rrijetësojnë kapacitetet krijuese të të rinjve dhe të nxisin përmirësimin e performancës së institucionove të qytetit.

### Iniciativa me suksesshme, projekti më interesant-përshkrim


Projekti “Qyteti i Maskave”, financuar dhe mbështetur nga LëvizAlbania ka si qëllim të ndikojë te politikat vendore nëpërmjet teatrit dhe formave të tjera të artit. Forumi i Atyre, pjesë përbërëse e projektit, dhe është një hapësirë ku një grup i hapur mund të reflektojë dhe të performojë në hije të ndryshme të pushtetit që ne përdorim në përditshmërinë tonë. Skena e eksperimentimit është vetë qyteti. Konsideruar si një bazë në të cilën është e mundur të vizatojmë eksperiencën e imagjinuar në të, Forumi i Atyre propozon qytetin si një mjet që hap udhëtimin drejt dekonstruktimit të performancës sonë të përditshme brenda tij.

### Forum i Atyre do të propozojë mënyra sesi mund të përmirësohet jeta kulturore e të rinjve të qytetit.

Forum i Atyre ka një specifikë gjeografike: Kamza. Gjeografikisht është konsideruar si periferia e Tiranës, historikisht Kamza është një qytet i ndërtuar gjatë migrimit të brendshëm post-komunist (1991) pjesa më e madhe e të cilëve i përkasin pjesës veriore të Shqipërisë.

Forumi i Atyre beson që gjuha performative e aktivizmit mund të ngrihet artistikisht për të banuar në teatër. Vizioni dhe drejtimi artistik i Forumit të Atyre, ndjekur nga artistja Valentina Bonizzi merr elemente nga Pedagogjia e të Shtypurve të Paolo Freire, dhe Teatrit Legjislativ të Augusto Boal për të vendosur në skenë një performancë qytetarie krijuar nga njerëzit e Kamzës. Grupi i hapur i Forumit të Atyre zhvillon takime dy herë në muaj, në ndryshim të vazhdueshëm, bazuar tek nevojat e grupit për aktet që duhen zhvilluar në qytet, drejt një reflektimi teorik tek qendra e grupit ATA. Dija e fituar gjatë takimeve do të krijojë skriptin e performancës finale që do të zhvillohet në teatrin e qytetit këtë vit.

Qëllimi i Grupi ATA nëpërmjet një projekti më të gjërë me titull “Qyteti i Mas-kave” dhe më specifikisht me Forumin e Atyre është që të artikulojë kërkesat për të përmirësuar performancën e insitucioneve kultutore, arsimore dhe vendimmarrëse në qytet nëpërmjet dialogut dhe akteve performative. Duke u fokusuar veçanërisht në kapitujt VI dhe VII të ligjit nr.139/2015 „Për vetëqeverisjen vendore“ me qëllim njohjen e qytetarëve me të drejtën e informimit, nxitjen e tyre për të marrë pjesë në buxhetim, njohjen me përgjegjësitë e bashkisë dhe gjetjen e mënyrave efikase për të ndikuar në vendimmarrjen lokale.





## “KLUBI SOCIAL KORÇË”

**Emri i shoqatës:** “Klubi Social Korçë”

“Klubi Social Korçë” është një organizatë rinore që ka në fokus grupmoshat nga 14- 35 vjeç.

**Adresa :** “ Rruga: Pirro Dacolli, Lagj Nr 1, Nr 3, Korçë.”

Shoqata është krijuar në vitin 1998 dhe struktura e saj përbëhet nga asambleja e përgjithshme, bordi drejtues dhe ekzekutivi. Numri i anëtareve vajza- djem është 50% -50%.

### **Fushat kryesore ku operon organizata janë:**

- 1- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në rrugë paqësore
- 2- Barazia gjinore
- 3- Krijimi i liderit rinor
- 4- Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, droges, alkoolit, duhanit, etj.
- 5- Mbështetje të arsimimit të fëmijëve dhe të rinjve në nevojë dhe orientimin në punësimin e tyre.
- 6- Mbrojtja dhe promovimi i fëmijëve, të rinjve dhe të rejave në nevojë.
- 7- Mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit.

Kjo organizatë është krijuar në vitin 1998 nga të rinjtë dhe specialistë që janë marrë me çështjet e të rinjve. Ajo u krijua si një nevojë për të ndikuar në orientimin e të rinjve në tranzicionin e vështirë e të gjatë shqiptar duke parë shumëllojshmërinë e problemeve që kjo grupmoshë kishte dhe mungesën e informacionit në të gjithë fushatë lartpërmendura që mbulon organizata, u ideuan nga një grup individesh që mundësuan krijimin e organizatës “Klubi Social Korçë.

Një nga iniciativat më të suksesshme të Klubit Social, ka qenë projekti i Parlamentit Rinor, Prefektura Qarku Korçë, një projekt 12-vjeçar i mbështetur nga UNICEF. Ky projekt përfshinte të gjithë të rinjtë e shkollave të mesme deri në moshën 18 vjeçare të prefekturës Qarku Korçë dhe ky projekt kishte për qëllim:

- 1- Të edukonte brezin e ri me organizimin e fushatave zgjedhore dhe mënyrën se si duhej të votohej.
- 2- Krijimin e institucionit të debatit midis këtij forumi të zgjedhur dhe institucioneve ku ata ishin, si shkolla dhe interesimi për çështje të ndryshme që ata hasnin në shkollë dhe në jetë si edukimi, barazia gjinore, çështjet e mjedisit, problemet e punësimit, problemet e shumta sociale si droga , mjedisi, prostitucioni, etj. Ky aktivitet përfshinte edhe krijimin e liderit rinor nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave të parlamenteve të ndryshme dhe finalizohesh në fund të vitit me një takim të të gjithë deputetëve të parlamentit rinor shqiptar në mjediset e kuvendit popullor. Aty, deputetët e parlamentit rinor në vite kanë kontaktuar me të zgjedhurit e kuvendit popullor, si kryetarë kuvendi, ministra të rinisë, etj.





**Numri i aktivisteve:** 30 aktivistë; 18 vajza dhe 12 djem të cilët janë të rinovueshëm.

## KËSHILLI RAJONAL RINOR KUKËS

**Misioni:** Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.

**Objektivat:** Të llobojmë për kapacitetet rinore në shoqëri.

Të rritet angazhimi i të rinjve në komunitet.

Të monitorojmë mbledhjet e këshillit bashkiak, duke i parë ato si katalizatorë ndryshimi për të rinjtë.

**Numri i aktivisteve:** 30 aktivistë; 18 vajza dhe 12 djem të cilët janë të rinovueshëm.

### Grupi rinor: PLANTASTIK

Ky grup rinor ka 10 vite që vepron në qytetin e Lezhës duke realizuar aktivitetete të ndryshme me natyre sociale nga të rinjtë e këtij qyteti.

**Adresa:** Rruga "Kol Toma" Lezhë

**Kontakte:** tel 0672749397

**Mail:** majlindatoma0@gmail.com

Personat që e menaxhojnë këtë grup janë 3:

- Majlinda Toma - supervizorja e grupit
- Lindita Toma - Koordinatorë
- Liza Brunga - Koordinatorë
- Adelinda Toma – Koordinatorë

Partnerët që kemi janë të shumtë, duke pasur bashkëpunime në nivel lokal si dhe OJF të ndryshme që operojnë në qytetin e Lezhës si:

1. Bashkia Lezhë
2. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Sociale
3. Drejtoria e Shëndetësisë
4. Policia.

OJF:

1. World Vizion
2. Mery World Loreto,
3. Kryqi i Kuq Shqiptar,
4. Peace Koorps,
5. Ambasadorët e Paqes etj

### Historiku:


Nisi si projekt pilot nga grupi ASAN, si i pari "Këshill Rajonal Rinor" në qytetin e Kukësit. KRRK përbëhet nga një grup të rinjsh e të rejash, me qëllimin e vetëm për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje duke sjellur përmirësim e situatës së të rinjve në komunitet. Ajo çfarë spikat më shumë në KRRK është barazia gjinore në cdo aspekt dhe puna e palodhshme e këtyre të rinjve e të rejave.

**Aktivitetet kryesore që ky grup ka ndërmarrë prekin kryesisht sferat sociale:**

Mbrojtjen e fëmijëve nga format e ndryshme të dhunës, dhuna me bazë gjinore, vullnetarizëm dhurim për familjet në nevojë, kundër trafikimit të genieve njerëzore, lufta kundër duhanit dhe drogave të ndryshme, bullizmi etj.

Ky grup rinor është krijuar që në vitin 2008 ku fillimisht këta të rinj filluan të identifikonin problemet e ndryshme sociale që ata hasnin, sfidat me të cilat përballeshin e më vonë filluan që të ndërtoheshin strukturat e këtij grupi duke i dhënë kështu mundësi që të hartoheshin plane e projekte për adresimin dhe zgjidhjen e rasteve të ndryshme problematike. Me kalimin e kohës ky grup shikohej si një vend ku të rinjtë mund të ndanin problemet por edhe të shprehnin idetë si dhe t'i konkretizonin ato.

Projekti më interesant është realizuar në 2010, ishte koha kur ky grup po fillonte të konsolidohej, gjatë asaj kohe në qytet nga anketat dhe pyetësorët që po realizoheshin shikohej që numri i të rinjve që po drogohej po shkonte gjithnjë e në rritje. Të rinjtë e grupit vendosën që të realizonin një film që të kishte më shumë impakt tek të rinjtë. Filmi u shfaq dhe audiencia ishte e lartë si dhe ndikimi tek të rinjtë ishte i madh. Edukimi nëpërmjet artit ishte shumë herë më produktiv se cdo fjalë e cdo trajnimi të realizuar. Prandaj kjo është parë nga grupi si eksperiencia më produktive në vite.



**ORGANIZATA QENDRA RINORE PUKE** është një organizatë lokale që vepron në Pukë (Rajonin e Pukës) dhe ka në fokus angazhimin e të rinjëve në jetën publike, politike e komunitare .

Qendra përbëhet nga bordi drejtues dhe ka rreth 25 aktiviste vullnetarë ndër të cilët 12 vajza dhe 13 djem.

Kryesisht përdorim rrjetin social facebook në adresën **Levizja Rinore Puke, dhe wwb. [www.lrd-albania.org](http://www.lrd-albania.org)**.

#### **Qëllimet e qendrës janë:**

- Nxitja e shpirtit krijues tek të rinjtë, zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme rinore, sipas ideve dhe propozimeve të të rinjëve.
- Nxitja e të rinjëve për t'u bërë pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes komunitare dhe politike në përmirësim të tashmes dhe së ardhmes së tyre.
- Pjesëmarrje në fushata të ndryshme sensibilizimi etj.

#### **Kemi zbatuar projekte me mbështetjen e:**

1. OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER dhe Sida Suedi "Aktivizimi rinor per qeverisje te mire vendore"
2. Leviz Albania "Leviz per demokracine vendore"
3. PACT "Partner se bashku kundër korrupsionit"
4. Komuniteti i Helsinkut "Shoqëria civile kundër ekstremizmit të dhunshëm"
5. Save the Children " Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri"

Qendra Levizja rinore per demokraci ( LRD) është një organizatë joqeveritare, jopolitike, jofetare dhe jofitimprurëse e cila eshte krijuar ne korrik te vitit 2011. Misioni i Qendres eshte kontributi i përbashkët në mbështetjen e ndryshimeve të jetës shoqërore e publike të zhvillimit dhe progresit demokratik të jetës së komunitetit. LRD Puke ka filluar implementimin e projektit "Aktivizimi rinor per qeverisje te mire vendore" i cili ka per qellim nxitjen dhe angazhimin e te rinjeve te qytetit Puke dhe te zonave te njesive vendore per t'u perfshire ne vendimmarrje. Projekti eshte financuar nga Olof Palme International Center dhe Sida Suedi. Ky projekt eshte fokusuar kryesisht ne seminare, trajnime, fushata sensibilizimi me tema te ndryshme me fokus kryesor te rinjte e gjimnazit, klasat e nenta, te rinj te papune, grate, shtresat ne nevojë etj. Donatori kryesor që na ka mbështetur është OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER dhe Sida Suedi. Iniciativat me te sukseseshme janë POP 2015, Kontrata sociale mes te rinjeve dhe kryetarit te bashkise per realizimin e prioriteteve te propozuara nga vete te rinjte (6 prioritete). Vleresimi i qeverisjes nga Komuniteti proces i cili ka prodhuar nje plan veprimi dhe monitorimi per te permiresuar tregues te ndryshem ne lidhje me te rinjte dhe kerkesat e tyre.

POP 2017 "Perballja e ofertave politike" per zgjedhjet parlamentare 2017 eshte finalizuar me nje pakt social i mbajtur ne mes komunitetit dhe antareve te parlamentit shqiptar per permbushjen e tre prioriteteve ne rang kombetar dhe 7 prioritete ne rang vendor te propozuara nga banoret ne zonat rurale e urbane te bashkise Puke.

### **Disa nga temat kryesore te trajnimeve qe jane zhvilluar:**

- Te drejtat e njeriut;
- Nxitja e pjesemarrjes se te rinjeve ne vendimmarrje dhe politikeberje, ndikimi i tyre ne permiresimin e jetes komunitare;
- Mbeshtetja nga pushteti lokal dhe keshilli i bashkise per evidentimin e nevojave te te rinjeve;
- Llogaridhenia dhe transparencja e pushtetit vendor por dhe e institucioneve te tjera;
- Se bashku bejme ndryshimin;
- Nje rini e mire edukuar dhe e shendetshme na paraprin per nje shoqeri me te bukur ne te ardhmen;
- Trajnime per advokaci dhe lobim;
- Trajnim per rritjen e aftesive monitoruese;
- Trajnime me teme qytetaria dhe qytetaria aktive;
- Trajnim per njohjen e kerkesave te tregut te punes dhe pershtatja e studimeve mbi politika te shendosha punesimi;
- Rendesia e pjesemarrjes ne votime;
- Buxhetimi me pjesemarrje;
- Te rinjte kane marre pjese me aktivitete te ndryshme sensibilizuese ne ditën e shendetit, te ambientit, te tokes, te ujit, te vullnetarizmit, ne ditën e rinise, etj;
- Monitorimi i pushtetit vendor dhe keshillit bashkiak permes Vleresimit te qeverisjes nga komuniteti;
- Vullnetarizmi, vleresimi dhe rendesia e punes vullnetare;
- Rritje kapacitetesh etj.

### **Objektivat e Qendres jane:**

- Njohja dhe përkrahja e principeve, ideve dhe përparësive të pjesmarrjes qytetare në jetën e vendit;
- Të aftësojë shoqërinë për të arritur barazinë;
- Të përmirësojë nivelin edukativ të të rinjve;
- Inkurajimi i lëvizjeve qytetare dhe iniciativave për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me përmirësimin e politikave lokale dhe qendrore të qeverisjes, çështjeve të mjedisit, të shëndetit të njeriut, të rinisë, gruas, grupeve në nevojë, kulturës, shkencës;
- Krijimi i një forumi për diskutimin e plotë të të gjitha subjekteve me interes publik;
- Të ndërgjegjësojë dhe aftësojë qytetarët për të mbrojtur shëndetin e tyre duke parandaluar sëmundje të ndryshme të rrezikshme si edhe t'u vijë në ndihmë personave me aftësi të kufizuar dhe/ose atyre që vuajnë nga sëmundje/patologji të ndryshme duke lehtësuar kushtet e tyre për jetese më të mirë dhe për një jetë sociale më cilësore;
- Të mbrojë dhe të promovojë të drejtat e grupeve të komunitetit në nevojë: grave, fëmijëve dhe të rinjve etj;
- Të ndihmojë grupet në nevojë nëpërmjet sigurimit të kushteve dhe shërbimeve të nevojshme për një jetesë të mirë;
- Të promovojë pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje nëpërmje të mbështetjes që do t'i japë te rinjve duke afruar dhe asistencë teknike, mbështetje administrative dhe institucionale;
- Të ndihmojë dhe asistojë organizatat jofitimprurëse, në përmbushjen e qëllimeve të tyre publike, të cilat kanë të bëjnë me gruan, rininë, grupet në nevojë, mjedisin, kulturën, shëndetin, etj.





## QENDRA ACT FOR SOCIETY/ ACT FOR SOCIETY CENTER (AFS)

**Email:** actfsociety@gmail.com

**Web:** www.actforsocietycenter.org

**Tel:** +355 04 450 7447

**Facebook:** Center ACT for SOCIETY  
<https://www.facebook.com/CenterACTforSOCIETY/>

**Instagram:** actforsociety  
<https://www.instagram.com/actforsociety/>


**Adresa:** Bulevardi "ZHAN D'Ark" Ndërtesa 61, Hyrja 5, Apartamenti 24, Tiranë, Shqipëri.

### Fushat e veprimt:

1. Të drejtat e njeriut dhe zhvillimi social
2. Demokracia dhe anti-korrupsioni
3. Ngritja e kapaciteteve dhe kërkimi shkencor
4. Fuqizimi I të rinjve
5. Ndërtimi i paqes dhe kultura

### Partneritetet:

CARE International, OAK Foundation, Austrian Development Agency, Rrjeti Zëri i të Rinjve, Anna Lindh Foundation Network Albania, UNITED for Intercultural Action, Kongresi Rinor Kombëtar, Bordi Rinor i Tiranës, CIJA US., AMSHC, Council of Europe, Netherlands Embassy, MasterPeace International, European Commission, European Youth Foundation, Raiffeisen Bank, IRIS.



Qendra "ACT for SOCIETY" është një qendër jo-fitimprurëse, e cila operon në Tiranë që nga viti 2012. Kjo qendër është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me vendim nr.709, datë 05.01.2012. Qendra ka gjithësej 5 punonjës, nga të cilët 2 janë me kohë të plotë, 2 punonjës janë me kohë të pjesshme me ekspertizë në fusha të ndryshme sociale, politike dhe ekonomike. Të gjithë punonjësit kanë qenë dhe janë aktiv në mbarëvajtjen e aktiviteteve të organizatës. Misioni i Qendres "ACT for SOCIETY" është "të rrisi jetesën e shëndetshme, të stimulojë zhvillimin e qëndrueshëm, të promovojë kulturën, të advokojë për demokraci dhe çështje të drejtave të njeriut, duke stimuluar pjesëmarrjen aktive në proceset shoqërore dhe vendimmarrëse". Nëpërmjet këtij misioni qendra kontribuon në mbrojtjen e të drejtave të grupeve të marginalizuara, në përfshirjen sociale dhe qytetarinë aktive si pjesë e të drejtave të njeriut, duke i dhënë mundësinë për pjesëmarrje të barabartë në shoqëri.

"Burrat dhe djemtë si partner në promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e ekstremizmit rinor dhe dhunës në Ballkan" projekti ka filluar më 1 tetor 2017 dhe zhvillohet në bashkëpunim me CARE International Balkans si dhe me mbështetjen e OAK Foundation dhe Austrian Development Agency. Ky projekt ndërtohet mbi përpjekjet gjithëpërfshirëse dhe program ore të CARE për të luftuar dhunën ndërpersonale dhe dhunën me bazë gjinore (GBV) si dhe përmirëson barazinë gjinore në rajon dhe adreson çështjet parandaluese që lidhen me ekstremizmin dhe dhunën rinore. Objektiva e projektit është të mundësojë shoqëri positive dhe paqësore për të rinjtë në Serbi, Kosovë, Shqipëri dhe Bosnjë e Hercegovinë, që mbështesin barazinë gjinore, ulin dhunën ndërpersonale dhe ekstremizmin e saj. Nëpërmjet këtij projekti do të arrihen gjithësej 56.800 njerëz: 150 mësues, 5000 studentë, 150 studentë universiteti, 50.200 të rinj, 1100 prindër / qytetarë, 100 anëtarë të komunitetit dhe 100 udhëheqës të lëvizjes. Programi Y si metodologji kryesore e këtij projekti, është një qasje inovative për të rinjtë në parandalimin e GBV dhe promovimin e jetesës së shëndetshme për burrat e rinj dhe gratë e reja. Ai përfaqëson një program të ri arsimor për parandalimin e dhunës dhe promovimin e mënyrave të jetesës së shëndetshme.







## TPA CENTER

**Vendndodhja:** Bulevardi Ismail Qemali, Lagjja Lef Sallata, Vlorë Shqipëri

**Struktura:** Qendra përbëhet nga një Bord prej 5 anëtarësh bashkëthemelues, të cilët janë të kualifikuar dhe të trajnuar në fushat e tyre të ekspertizës/studimit.

### Numri i aktivistëve:

Numri i tyre ndryshon në varësi të aktiviteteve. Ata janë studentë apo gjimnazistë të Qarkut të Vlorës, të interesuar që zëri i tyre të dëgjohej në procese vendimarrjeje që u përkasin atyre, të interesuar të shprehin perceptimet e tyre, të angazhuar për një shoqëri ku të respektohen idetë e tyre, ku ata të ndihen të barabartë ndërmjet tyre dhe në kërkim të organizatave që do t'i udhëheqin dhe mentorojnë gjatë aktiviteteve të ndryshme.

### Fushat kryesore të veprimit:

Objekti i veprimtarisë së organizatës është kryesisht në fushat e demokracisë lokale; të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm; të qytetarisë aktive; përfshirjes sociale dhe inisiativave dhe pjesëmarrjes së të rinjve në vendimarrje. Aktivitetet parashikojnë të përfshijnë studime, konferenca, trajnime, seminare, publikime dhe çdo veprimtari tjetër në funksion të realizimit të qëllimit dhe objektivave të organizatës.

### Partneritete kryesore:

si një organizatë e krijuar rishtazi dy janë partnerët tanë kryesore, Kolegji Universitar Pavarësia Vlorë dhe Këndi i BE-së Bashkia Vlorë.

**Për Kontakt:** Sekretar i Përgjithshëm/ Blerina Dhrami:

**email:** blerina14@yahoo.com,

**cel:** 0694416518.

**Media sociale:** faqet e qendrës janë ende në ndërtim.

### Mini historik

Ky bashkim i yni ka qenë një projektim i hershëm i inisiativave të anëtarëve. Pas eksperiencave të ndryshme, pjesëmarrjes në trajnime si Trajnues, Koordinatorë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, gjithmonë në kontakt me të rinjtë menduam se ishte çasti i volitshëm për të formuar këtë qendër me një vizion të qartë dhe të qëndrueshëm të tillë si ushtrimi i veprimtarive kërkimore shkencore multidisiplinare dhe bashkëpunimi dhe bashkërendimi me aktorë vendas e të huaj, shtetërorë e jashtetërorë për të adresuar zgjidhje me karakter komunitar, duke krijuar modelin e të menduarit, planifikimit dhe veprimit. Dëshirojmë të jemi një mjet për ata individë (sidomos të rinj) që duan të marrin pjesë në zhvillimin dhe ndryshimin social përtëj programeve të qeverisjes qendrore dhe lokale (një mjet ndryshe).

Edhe pse pak muaj jetëgjatësi kemi luajtur një rol mbështetës në aktivitete të zhvilluara në Qarkun e Vlorës, të fokusuara në target grupe të vecanta si gratë profesioniste, kërkuesit e rinj apo të rinjtë si kontigjent për tregun e punës.

### Iniciativa të sukseshme

Ashtu si për të gjithë ata që krijojnë, prodhojnë edhe për qendrën tonë aktiviteti i momentit është ai që na motivon më shumë. Jemi në prag të javës së BE-së. Me iniciativë të Kolegjit Universitar Pavarësia Vlorë (KUPV), do të zhvillohet një Konferencë Rinore me perceptime të rinjsh. Një forum i cili mbledh studentë e gjimnazistë pro dhe ndoshta kundër këtij integrimi. Por, sa të informuar janë veçanërisht të rinjtë për këtë process, për mundësitë që ju ofrohen dhe në cilat fusha; a i përgjigjet dinamika e zhvillimeve politike në kuadër të integritit nevojave dhe kërkesave të tyre?

Roli i qendrës është mbështetës për këta të rinj, i orientojmë, i asistojmë në hulumtimin e tyre; redaktojmë punimet e tyre, i mentorojmë gjatë shkruarit dhe i motivojmë që ata të rritin interesin e tyre për efektet në qytetarët, ekonominë, sfidat dhe perspektivat e pritshme për Shqipërinë, por edhe më gjerë, në Rajon në kuadër të këtij integrimi.

Gjithashtu rë rinjtë do të vlerësohen për punimet e tyre me tre çmime, të ofruara/mbështetur nga KUPV.

Qendra ka krijuar një data bazë të të rinjve që do të marrin pjesë në konferencë, të cilët do të pajisen me certifikata dhe me kopjen e botuar të punimeve të tyre. Kjo data bazë do të shërbeje gjithashtu për thirrje dhe aktivitete të tjera.



## KAPITULLI IV

IMPAKTI , QËNDRUESHMËRIA ORGANIZATIVE  
DHE FINANCIARE

## ORGANIZATAT RINORE

Pse ata që organizohen nga organizatat joqeveritare të drejtuara nga të rinjtë janë ato që udhëhiqen plotësisht, menaxhohen dhe koordinohen nga të rinjtë? Në rastin e një organizate, kjo do të thotë që stafi dhe anëtarët janë të gjithë nën një moshë të caktuar dhe që punojnë në një sërë çështjesh nga perspektiva e të rinjve. Ndërsa organizatat e drejtuara nga të rinjtë janë bërë gjithnjë e më të dukshëm në arenat ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare, shumë prej tyre ende përpiqen të fitojnë njohjen si lojtarë të rëndësishëm në proceset vendimmarrëse ndërkombëtare. Tani më shumë se kurrë, organizatat e drejtuara nga të rinjtë janë kritikë për përparimin e shëndetit publik për shkak të numrit absolut të të rinjve në botë sot. Aktualisht, pothuajse gjysma e popullsisë në botë është nën 25 vjeç - kjo është tre miliardë njerëz të rinj. Vetëm këto shifra mund të shpjegojnë pse kaq shumë programe dhe politika sot kanë filluar të përqëndrohen tek të rinjtë. Është e qartë se të rinjtë luajnë një rol kritik për të udhëhequr iniciativat dhe zhvillimin e politikave kur ato përbëjnë një pjesë aq të rëndësishme të popullsisë së botës. Organizatat e drejtuara nga të rinjtë janë gjithashtu të rëndësishme sepse përmes punës së tyre u mundësojnë të rinjve të ushtrojnë të drejtën e tyre për pjesëmarrje (për t'u përfshirë, për të udhëhequr dhe për të ndërmarrë veprime) në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tyre në mbarë botën.

Pjesëmarrja mund të nënkuptojë përfshirje aktive në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e aktiviteteve zhvillimore, programeve dhe politikave që ndikojnë në jetën e tyre. Së fundmi, organizatat e drejtuara nga të rinjtë luajnë një rol kyç në kontributin për suksesin e programeve, projekteve ose iniciativave që lidhen me të rinjtë. Të rinjtë kanë kuptimin më të mirë të sfidave, pikat e forta dhe mundësitë që i prekin ato. Organizatat e drejtuara nga të rinjtë janë në një pozitë unike për të zhvilluar dhe zbatuar iniciativa që adresojnë çështje nga perspektiva e të rinjve dhe ofrojnë zgjidhje që u përgjigjen realiteteve të ndryshme të të rinjve. Kur të rinjtë janë përfshirë në mënyrë domethënëse në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve, politikave dhe shërbimeve të lidhura me të rinjtë, këto iniciativa mund të jenë më efektive dhe në fund të fundit më të qëndrueshme.



Me qëllim arritjen e lidërshiptit të qëndrueshëm të rinisë, një angazhim dhe investim të fortë nga të rinjtë, udhëheqësit dhe organizatat rinore janë të nevojshme, përveç mbështetjes së financuesve, organizatave jo-rinore, organizatorëve të takimeve dhe konferencave dhe organeve vendimmarrëse. Ky dokument siguron njohuri për sfidat unike me të cilat ballafaqohen organizatat rinore, të ndjekura nga rekomandime konkrete se si të gjithë aktorët mund të mbështesin dhe lehtësojnë më së miri udhëheqësit e rinj

## REKOMANDIME PËR QËNDRUESHMËRINË NË ORGANIZATAT RINORE

### Sfidat dhe rekomandimet

Në vijim përshkruhen disa nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen organizatat e drejtuara nga të rinjtë. Disa nga këto sfida janë thelbësore për natyrën e organizatave të drejtuara nga të rinjtë dhe mund të parashikohen. Disa përshkruajnë sfidat me të cilat ballafaqohen edhe organizatat e tjera joqeveritare, megjithatë ato mund të intensifikohen më tej nga sfidat specifike të të rinjve.

1. Plakja - Për organizatat rinore të mbeten me të vërtetë të udhëhequr nga të rinjtë, ekziston një proces i quajtur "plakja", ku anëtarët dhe stafi kalojnë jashtë organizatës kur arrijnë një moshë të caktuar. Moshë në të cilën stafi dhe anëtarët e moshës varet nga organizimi dhe konteksti i tij kulturor. Në disa organizata të të rinjve, të rinjtë janë të moshës kur dalin 25 vjeç, ndërsa në të tjerat ata mund të moshës kur kthejnë 30 vjeç. Si rezultat, organizatat rinore janë në një gjendje konstante të tranzicionit. Me plakjen vijnë anëtarë dhe stafi të rinj, njohuri, ide dhe aftësi të reja, por gjithashtu do të thotë humbje e mundshme e histories organizative, njohurive, aftësive, kontakteve dhe më shumë.
2. Lëvizshmëria e lartë - Përveç normave të shpeshta të kthimit midis stafit dhe anëtarëve për shkak të plakjes, lëvizja e lartë e të rinjve është një sfidë. Të rinjtë shpesh duhet të lëvizin për shkak të shkollës, punës ose familjes. Për organizatat e drejtuara nga të rinjtë, kjo do të thotë qarkullim shtesë pasi anëtarët dhe stafi kalojnë jashtë para plakjes.
3. Orientimi, trajnimi dhe ri-trajnimi i vazhdueshëm - Ndërkohë që lidërshipi i ri është një gjë positive për organizatat e drejtuara nga të rinjtë për të qëndruar besnik ndaj structures së tyre, ajo gjithashtu krijon një nevojë të vazhdueshme për të orientuar, trajnuar dhe riorganizuar anëtarët dhe stafin.
4. Mundësitë e lidërshiptit për një numër të caktuar - Organizatorët takimesh shpesh ftojnë të njëjtët individë të rinj, sepse ata janë të njohur vetëm me disa udhëheqës të rinj.
5. Krijoni një proces nominimi që maksimizon aksesin në mundësi për sa më shumë anëtarë të jetë e mundur, në krahasim me vetëm disa të zgjedhur. Ndërsa mundësitë për angazhimin e të rinjve mund të vijnë në minutën e fundit me afate të ngushta, duke e bërë të vështirë për të mbledhur informata për një përzgjedhje më të gjerë të të rinjve për të emëruar, mund të ndërmerren hapa për të lehtësuar kanalizimin e mundësive për një numër më të madh të të rinjve. Për shembull, dërgimi i alarmeve për mundësitë në një listë të anëtarëve ose përmes rrjeteve të tjera mund të zgjerojë shtrirjen e mundësive urgjente për angazhimin dhe udhëheqjen e të rinjve. Gjithashtu, krijimi i një baze të dhënash të brendshme të bios dhe /ose fotografive të anëtarëve të organizatës mund të ndihmojë në miratimin e rekomandimeve për thirrjet për pjesëmarrjen e rinisë, folësit, punën mediale ose angazhimet e tjera.

6. Përgatitni anëtarët ose stafin me informacionin dhe trajnimin e nevojshëm për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre kuptimplote nëse përzgjidhet për mundësi ose ngjarje të veçanta. Për shembull, ofroni trajnime për të folur publikisht nëse përzgjidhet për një prezantim, në rolin e një anëtar të bordit, nëse rekrutohet për të shërbyer në një bord të drejtorëve, ose si të flisni me një gazetar nëse jeni ftuar për një intervistë.

7. Krijimi i politikave, planeve dhe buxhetit për shpërblim ose forma të tjera të kompensimit për përpjekjet dhe kohën e të rinjve. Krijimi i politikave organizative që lidhen me shpërblimin dhe buxhetin, si dhe zbatimin e këtyre politikave në mënyrë konsistente. Përshembull, a do të paguhen anëtarët për kohën e tyre dhe /ose do të marrin një pagesë për të mbuluar transportin në takime dhe ushqim?

8. Kërkoni mundësi për partneritete me organizata të tjera të drejtuara nga të rinjtë dhe që shërbejnë për të rinjtë dhe punoni në koalicion për të rritur përpjekjet. Kur resurset janë të kufizuara, partneritetet janë kritike për avancimin e përpjekjeve dhe ndërtimin e iniciativave ekzistuese dhe plotësuese. Kërkoni financim nga burime të ndryshme nëse është e mundur, duke përfshirë qeverisjen vendore, fondacionet private, agjencitë ndërkombëtare ose financuesit individualë. Marrja e fondeve, sado e vogël, nga entitete të ndryshme siguron më shumë fleksibilitet organizativ, si dhe sigurinë financiare.

## CROWDFUNDING

Me zhvillimet e reja teknologjike, shumë procese janë bërë më të lehta me prezantimin e internetit, duke përfshirë këtu ngritjen e fondeve. Marrja e donacioneve nga persona fizik të cilët nuk i njejnë përmes internetit quhet *crowdfunding*. Koncepti i *crowdfunding* megjithëse i vjetër në ekzistencën në botën fizike, vetëm në dekadën e fundit është ka marrë formën që e njohim ne sot.

Një nga platformat më të njohura për *crowdfunding* është *gofundme.com*. Filluar në vitin 2010, ajo është platforma më e madhe e mbledhjes së fondeve në botë, me mbi 5 miliardë dollarë të mbledhura deri më tani. Me një bashkësi prej më shumë se 50 milion donatorësh, *GoFundMe* jep një mundësi shumë të mirë për të mbledhur para.

Gjithëkush mund të përdori portale *crowdfunding* pavarsisht nga forma që është krijuar, si individ, grup informal, apo organizat. Procesi i të kërkuarit të një financimi transferohet nga donatori te njerëzit e thjeshtë të cilëve i duhet treguar se përse ajo për çfarë ju po kërkoni financim është e nevojshme, dhe se si paratë që ata po japin do sjellin një ndryshim. Në ndryshim nga aplikimi i një projekti, këto metoda janë më pak burokratike dhe duan më pak kohë, por ama rrezikojnë që ju të mos mund të merrni të gjithë shumën e nevojshme për të realizuar qëllimin tuaj, duke krijuar potencialisht mundësinë që pavarsisht se arrini të tërhiqni fonde, të mos mund ti përdorni dot ato.

